

**PËRGATITJE**  
**PËR RAMAZAN**

*Transkriptim i nje serie ligjeratash*

Titulli i librit: **“Përgatitje për Ramazan”**

Ligjëroi: Hoxhë Petrit Perçuku

Transkriptoi: Albiona Olluri

(E pabotuar)

## RAMAZANI, GËZIMI I BESIMTARIT

Ramazani, ky muaj i bekuar e madhështor, është një shans dhe një dhuratë e madhe prej Allahut, nëse njeriu e shfrytëzon duke shtuar veprat të cilat afrojnë tek Allahu, atëherë pa dyshim se do të arrijë mirësi të shumta. Është një dhuratë e madhe nëse Allahu ta mundëson arritjen e këtij muaji madhështor. Të gjithë muslimanët i gëzohen ardhjes së Ramazanit. Por, ku është sekreti i kësaj? Ka shumë faktor të cilët bëjnë që muslimani t'i gëzohet këtij muaji. Nga to janë:

**1. Për shkak të shpërblimit të madh të cilin Allahu e ka vendosur në këtë muaj madhështor, shembull: agjërimi i Ramazanit është rrugë që çon drejt xhenetit. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "Kush e agjëron Ramazanin me besim (se Allahu e ka bërë obligim) dhe duke llogaritur shpërblim tek Allahu, i falen mëkatet e kaluara."** Buhariu dhe Muslimi.

**2. Për shkak se në këtë muaj hapen dyert e xhenetit dhe mbyllen dyert e zjarrit. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "Kur të vijë Ramazani**

**hapen dyert e xhenetit dhe mbyllen dyert e zjarrit dhe prangosen djajtë."** Buhariu dhe Muslimi. Si rezultat i këtyre, muslimani shton veprat të cilat e afrojnë tek Allahu dhe e shfrytëzon këtë muaj madhështor në vepra të shumta e të llojllojshme. Në një hadith tjetër ka thënë: **"Në natën e parë të Ramazanit, prangosen djajtë e xhindët e rebeluar dhe mbyllen dyert e zjarrit dhe asnjë prej tyre nuk hapet dhe hapen dyert e xhenetit dhe asnjë derë e tij nuk mbetet pa u hapur. Një thirrës thërret: "O ti që synon të mirën, angazhohu me punë të mira! O ti që synon të keqen, tërhiqu!" Dhe Allahu liron shumë njerëz nga zjarri i xhehenemit në çdo natë të Ramazanit."**

3. Për shkak të një ndjesie madhështore e të mrekullueshme shpirtërore, të cilën Allahu e hedh në zemrat e njerëzve. Kjo vjen edhe si rezultat i asaj kur njeriu sheh të tjerët duke nxituar në vepra të mira dhe duke bërë gara se kush nga ta po vepron më shumë.

4. Në këtë muaj shtohet vigjilenca dhe nxitimi drejt punëve të mira.

5. Në këtë muaj realizohen punë madhështore, të cilat njeriu nuk ka pasur mundësi t'i kryejë më herët.

6. Për shkak të agjërimit, iftarit, namazit të teravive, lutjeve, të gjitha këto e bëjnë të ndjejë krenari se është musliman dhe se kjo fe është madhështore me të cilën Allahu na ka nderuar e na ka udhëzuar e që është rruga e drejtë.

7. Për shkak të iftarit. Kur vjen çasti i iftarit, besimtari sjell ndërmend begatinë e Allahut, i Cili pas disa orëve të gjata adhurim e testim, ia ka lejuar të shuajë etjen dhe urinë përmes ushqimit të pastër e të lejuar. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **"Agjëruesi ka dy gëzime: njëri kur çel agjërimitin e tij dhe tjetri kur takon Zotin e Tij (në Ditën e Gjykimit, e Ai pastaj e shpërblen për agjërimitin dhe mundin që ka bërë në jetën e kësaj bote)."**

## GËZIMI PËR ARDHJEN E RAMAZANIT

Shpirtrat e njerëzve, gëzohen e lumturohen për ardhjen e Ramazanit. Andaj, muslimani duhet të shfrytëzojë këtë rast të volitshëm e madhështor, të dijë vlerën e kohës në të cilën jeton dhe të çmojë këtë dhuratë të Allahut e ta shfrytëzojë kohën e tij.

Fillimisht ajo çfarë kërkohet prej muslimanit është që ta falënderojë Allahun për besimin që ia ka dhuruar dhe që ia ka mundësuar të arrijë Ramazanin, këtë begati të madhe nga e cila janë privuar shumë njerëz.

Nga gjërat e pëlqyeshme është që muslimani të urojë edhe vëllezërit e tij për arritjen e këtij muaji.

≈Muslimani duhet ta presë Ramazanin me gëzim dhe përmallim, megjithatë ky gëzim duhet të jetë i shoqëruar me vepër, me seriozitet dhe me nxitim drejt punëve të mira, **“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit...”** Ali Imran 133.

≈Muslimani duhet ta gjallërojë Ramazanin me ambicie të larta, me vërtetësi në vendosmërinë e tij, në mënyrë që të triumfojë me bekimet e këtij muaji dhe të vjelë dobitë e tij.

≈Ai duhet të jetë i kujdesshëm që të lirohet prej angazhimeve të panevojshme, në mënyrë që t'i përkushtohet sa më shumë adhurimeve dhe të nxitojë drejt veprave që afrojnë tek Allahu, të cilat Ai i ka vendosur brenda këtij muaji dhe ka bërë që shpërblimi për to të shumëfishohet për shkak të bekimit të kohës së Ramazanit.

≈Muslimani i mirëfilltë duhet ta çmojë kohën e Ramazanit dhe të dijë vlerën e saj, e pastaj ta shfrytëzojë atë në punë të mira.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kur të vijë Ramazani, hapen dyert e xhenetit dhe mbyllen dyert e zjarrit dhe prangosen djajtë.”** Buhariu dhe Muslimi. A ka vlerë më të madhe sesa kjo? A ka mirësi më të madhe sesa kjo? A ka nxitje dhe inkurajim më të madh sesa ky?

Ai salAllahu alejhi ue selem përgëzonte shokët e tij dhe u thoshte: **“Ky muaj (Ramazani) është afruar. Në të është një Natë e cila është më e mirë sesa njëmijë muaj. Kush privohet nga ajo, është privuar nga çdo e mirë. Nuk privohet nga mirësia e saj veçse ai që vërtetë është i privuar.”**

≈Kërkohet prej muslimanit të përpiqet shumë që ta edukojë vetveten në kryerjen e mirësive dhe ta ruajë veten nga ndalesat, sepse jemi duke jetuar në një kohë kur mirësitë janë pakësuar dhe të këqijat janë shpeshtuar e janë bërë të llojlojshme. Duhet bërë kujdes në ruajtjen e agjërimit tonë nga gjërat të cilat e zhveshin nga shijimi i adhurimeve brenda Ramazanit dhe agjërimit.

## URIMI PËR RAMAZAN DHE SHFAQJA E GËZIMIT

Pa dyshim se arritja e muajit të Ramazanit është begati e Allahut, i Cili ka thënë: **“Me dhuntinë e Allahut dhe mëshirën e Tij - vetëm me këto le të gëzohen! Kjo është më e mirë se ajo që grumbullojnë.”** Junus 58. Andaj, ua urojmë të gjithëve arritjen e muajit të Ramazanit, që është begati e vërtetë prej Allahut dhe zotëria e të gjithë muajve.

Kur ne urojmë njëri-tjetrin për muajin e Ramazanit, kjo ka disa dobi:

-Bën që shpirtrat e njerëzve të lumturohen, të gëzohen e të përhapet gëzimi në mesin e tyre, për ardhjen e këtij musafiri të nderuar.

-Bën që të ngrihen ambiciet, të lartohen e të stimulohen vendosmëritë në mënyrë personi të veprojnë punë të mira sa më shumë, sepse kur tjetri ia përmend dikujt një gjë që e gëzon, ai do të nxitojë drejt saj dhe do të punojë për të, e Ramazani pa dyshim është shans për të nxituar dhe garuar drejt punëve të mira që afrojnë tek Allahu, i Cili ka thënë:

**“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit”**. Ali Imran 133.

Ramazani përmban falje gjynahesh nga Allahu, mëshirë të madhe dhe shumëfishim të veprave të mira. Kjo për disa arsye:

◆ Është muaji i vitit siç është transmetuar nga brezat e parë të Islamit.

◆ Është mburrje e krenari e të gjitha sezoneve të mirësisë që Allahu i ka vendosur në jetën e kësaj bote, në të ka zbritur Kurani në natën e Kadrit, **“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani”** Bekare 185.

◆ Në Ramazan zbret mëshirë e madhe e Allahut, shumëfishohen shpërblimet e punëve të mira, **“Për çdo natë të Ramazanit Allahu liron shumë njerëz nga zjarri i xhehenemit”** (Hadith).

◆ Në Ramazan zemrat hapen e gëzohen dhe muslimani ndjen në veten e tij një gëzim të jashtëzakonshëm, e kjo pastaj e nxit të sakrifikojë, të

japë mund dhe të nxitojë drejt punëve të mira. Kjo është e veçantë vetëm për muajin Ramazan.

◆ Në Ramazan ka llojllojshmëri të punëve të mira, të cilat muslimani mund t'i kryejë, siç është agjërimi, falja e namazit të natës, leximi i Kuranit, lëmosha etj., e pastaj nga kjo arrihet falja e Allahut dhe shpërblimet e mëdha e të shumëfishuara.

◆ Ai që e arrin Ramazanin ka përparësi ndaj atij të cilit Allahu nuk ia ka mundësuar të arrijë Ramazanin. Kemi ngjarjen e dy personave që kishin vdekur në kohën e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dhe Ebu Talha el Ensari kishte parë në ëndërr se ai që kishte arritur një Ramazan më shumë kishte hyr në xhenet para tjetrit, edhe pse ky kishte bërë përpjekje më shumë sesa ai në adhurime. Kur i treguan Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem për këtë, tha: **“E pse po çuditëni?! Ai që ka arritur një Ramazan më shumë ka falur kaq e kaq rekate namaz më shumë. Dallimi mes tyre është sa dallimi mes qiellit e tokës.”**

◆Në Ramazan rrugët e të këqijave ngushtohen dhe tkurren, kjo sepse shejtanët prangosën e lidhen me zinxhirë dhe se dyert e xhehenemit mbyllen, siç ka thënë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem: **“Kur të vijë Ramazani, hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e zjarrit dhe shejtanët prangosën e lidhen me zinxhirë.”**

## MËSIMET DHE URTËSITË E AGJËRIMIT TË RAMAZANIT

Çfarë mësojmë nga Ramazani?

Pa dyshim se çdo adhurim të cilin na ligjëson Allahu, ka sekrete, urtësi e mësimë të mëdha e të dobishme, që i përfitojmë në jetën tonë. Kur Allahu ligjëson një adhurim, këtë e bën ngaqë në të ka dobi të mëdha e rezultate të mahnitshme. Nga dobitë madhështore të Ramazanit përmendim:

*≈Ëmbëlsia e adhurimit ndaj Allahut. Kryerja e adhurimeve gjatë Ramazanit ka një shije tjetër të cilën e shijon ai që është i angazhuar me adhurim ndaj Allahut. Kryerja e adhurimeve në këtë muaj bën që njeriu të mbulohet nga gëzimi e lumturia dhe bën që t'i hapet zemra. Transmetohet nga njëri prej brezave të parë të Islamit se ka thënë: “Janë të ngratë ata persona që janë të dhënë tepër pas jetës së kësaj bote. Ata dolën nga jeta e kësaj bote pa e shijuar gjënë më të mirë në të.” E pyetën se çfarë është ajo, tha: “Përmendja e Allahut, prehja tek Ai dhe përmallimi për takimin me Atë.”*

≈*Durimi*. Gjatë agjërimit përjeton etje e uri, gjatë ditës, pastaj del në punën tënde, lëvizë, shkon, pa i kushtuar vëmendje etjes e urisë, përkundrazi duron dhe je i nënshtruar ndaj urdhrit të Allahut. Kjo ta mëson (kultivon) durimin në çdo gjë me të cilën përballesh në jetën e kësaj bote.

≈*Pastërtia e lumturia e shpirtit*. Ramazani është muaji i lumturisë. Ajo përtërihet çdo ditë te ne, veçanërisht në kohën e iftarit, siç tregon Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem: **“Agjëruesi ka dy gëzime, njëri kur çel iftarin dhe tjetri kur të takojë Zotin e tij (në Ditën e Gjykimit).”**

≈*Sakrifikimi, dhënia përparësi të tjerëve ndaj tekave e egos tonë*, duke iu ndihmuar me lëmoshë, duke iu shtruar iftare vëllezërve të tu muslimanë, duke bashkëndje në dhimbjet e tyre, duke qenë pjesëmarrës në gëzimet e tyre etj.

≈*Garimi në punë të mira*. Gjatë Ramazanit njeriu ndjen brenda vetes një forcë e cila e nxit drejtë punëve të mira, e pa dyshim ky është njëri prej sekreteve më madhështore të Ramazanit.

≈Përulja ndaj Allahut dhe meditimi i ajeteteve që lexojmë. Kur je duke lexuar Kuran gjatë Ramazanit, të duket sikur je duke i dëgjuar për herën e parë ajetet e tij. Gjithashtu namazi i natës, që ka dobi të mëdha të cilat i dinë vetëm ata që falen gjatë natës dhe e lusin Allahun.

≈Ramazani na mëson se agjërimi është shumë i lehtë, jo i vështirë siç mendojnë disa njerëz. Agjërimi është rrugë që afron tek Allahu, te dashuria e Tij. Kur personi agjëron Ramazanin sheh se agjërimi është i lehtë dhe ka mundësi të agjërojë edhe jashtë Ramazanit (andaj fillon të agjërojë të hënën e të enjten, apo tri ditë gjatë muajit).

≈Ramazani na mëson se si të jemi të bashkuar, sepse të gjithë muslimanët agjërojnë dhe e çelin iftarin në të njëjtën kohë.

≈Ramazani na mëson rëndësinë e madhe që ka lutja tek Allahu. Disa njerëz nuk i luten Allahut përveçse në Ramazan, ngaqë shohin të tjerët se si e lutin Atë, si e përmendin Atë, si ankohen tek Ai, dhe kjo pastaj u bëhet shprehi edhe jashtë Ramazanit.

≈*Ramazani na mëson moralin e mirë.* Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Nëse je agjërueshëm dhe dikush të ofendon apo të shan, i thua: “Unë jam agjërueshëm!”** Dhe nuk merresh me të.

≈*Ramazani na mëson teuhidin,* na bëhet e ditur përsosmëria e Allahut, se Allahu është i vetëmjaftueshëm e nuk ka nevojë për askënd, sepse ti sheh veten se je rob i dobët i Allahut: ndjen uri, etje, ke nevojë për ushqime e pirje, atëherë këtu të shfaqet përsosmëria e Allahut.

≈*Ramazani na mëson fuqinë e vendosmërisë.* Vërejmë se si në Ramazan shpirtrat gjallërohen e njerëzit bëhen aktiv. Andaj, nga kjo përfiton që edhe jashtë Ramazanit të jesh i tillë. Kështu shes se ke mundësi të jesh aktiv edhe pas tij.

≈*Ramazani na mëson vëllazërinë për hir të Allahut,* të bashkëndejmë me të tjerët, t’i duam muslimanët, t’i mëshirojmë, t’i ndihmojmë e të jemi të afërt me ta.

## GJËRAT QË E PRISHIN AGJËRIMIN

Allahu ligjësoi agjërimin e muajit të Ramazanit, megjithatë për këtë agjërim vendosi kushte, sunete, rregulla dhe gjëra që e prishin atë. Andaj, do të përmendim ato gjëra që e prishin agjërimin, që nëse agjëruesi i vepron, atëherë i prishet agjërimi i tij dhe detyrohet ta kompensojë atë. Ato janë:

1. **Ngrënia dhe pirja.** Kjo me njëzëshmëri nga të gjithë dijetarët islam. Ajeti është i qartë për këtë: “**Dhe hani e pini derisa të dallohet fija e bardhë (bardhësia) e agimit nga fija e zezë (errësira e natës), pastaj plotësojeni agjërimin derisa të bjerë mbrëmja.**” Bekare 187. Nëse agjëruesi ha apo pi duke e ditur se çfarë po bën, duke e ditur gjykimin fetar për këtë dhe duke qenë me vullnet të lirë (pa u detyruar e imponuar nga dikush), atëherë agjërimi i tij është i pavlefshëm dhe ai bën mëkat me këtë gjë. Atë ditë obligohet ta kompensojë pas Ramazanit.

2. **Kontakti intim.** Kjo me unanimitetin e muslimanëve. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem thotë në hadith kudsij se Allahu ka thënë duke e lavdëruar agjërimin: “**Agjëruesi braktis ushqimin,**

**pijen dhe epshin për hir Timin.”** Ai që ka kontakt intim gjatë ditës së agjërimit, obligohet pastaj me disa gjëra: duhet të përmbahet nga ushqimi e pija deri në perëndimin e diellit të asaj dite, duhet ta kompensojë atë ditë, duhet të bëjë shpagim të rëndë: të lirojë një rob besimtar (kjo në kohën tonë është e pamundur), nëse nuk gjen rob atëherë të agjërojë dy muaj rresht njërin pas tjetrit, e nëse nuk ka mundësi për këtë atëherë duhet të ushqejë 60 të varfër. Dhe e katërta, duhet të pendohet tek Allahu, të kërkojë falje prej Tij dhe të jetë i vendosur të mos i kthehet një veprimi të tillë.

3.Vjellja e qëllimshme, qoftë duke futur gishtat, apo duke nuhatur aromë të rëndë, apo duke shikuar pamje të gërditshme për të vjellë. Ndërsa, nëse e vjella vjen në mënyrë spontane dhe të padëshiruar, atëherë nuk prishet agjërimi. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Këdo që e mund e vjella pa dëshirën e tij, ai nuk duhet ta kompensojë atë ditë, ndërsa kushdo që e nxit veten të vjellë duhet ta kompensojë atë ditë.”**

4. **Dalja e spermës**, në çfarëdo mënyrë që bëhet me dëshirën dhe vullnetin e personit, qoftë përmes gjërave që i paraprijnë kontaktit intim apo përmes masturbimit, sepse edhe kjo është në kuptimin e kontaktit intim. Nëse burri vepron me bashkëshorten e tij gjëra që i paraprijnë kontaktit intim, e pastaj i del sekrecioni i epshit që i paraprinë spermës, atëherë agjërimi i tij nuk priset, sipas mendimit të saktë të dijetarëve. Gjithashtu agjërimi nuk i priset nëse ejakulon spermë gjatë gjumit, sipas mendimit unanimit të dijetarëve, porse pastaj obligohet të lahet (të marrë gusël për namaz).

5. **Menstruacionet dhe lehonja**. Kjo sipas mendimit unanimit të dijetarëve. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka treguar në hadithe se kur gruaja është me menstruacione apo lehonë, nuk duhet të agjërojë.

6. **Çdo gjë tjetër e llojit të këtyre që përmendëm**, si: tek ushqimi e pija futen infuzionet e injeksionet ushqyese (këto e prishin agjërimin), ndryshe nga injeksionet për t'i zbutur dhimbjet apo që nuk përmbajnë gjëra ushqyese, apo ndryshe nga pikat e syrit e të veshit (këto nuk e prishin agjërimin), sepse

syri e veshi nuk janë vende nga ku futet ushqimi, ndërsa sa i përket pikave të hundëve nëse ato arrijnë në fyt agjërimi prishet. Gjithashtu përdorimi i miswakut apo brusha e dhëmbëve nuk e prishin agjërimin, por nëse përdoret pasta e dhëmbëve duhet ta nxjerrim jashtë dhe duhet bërë kujdes të mos e përpijmë, ose duhet të ruhemi t'i pastrojmë dhëmbët para agjërimit. Përpirja e pështymës nuk e prish agjërimin, edhe nëse e tubon në gojë e pastaj e përpin. Këlbaza nëse është brenda në fyt nuk e prish agjërimin, e nëse e nxjerr me dëshirë te goja e pastaj e përpin atëherë disa dijetarë kanë thënë se kjo e prish agjërimin, e disa kanë thënë se nuk e prish dhe ky është mendimi më i saktë ngase nuk ka argument se kjo gjë e prish agjërimin.

## VEPRAT QË ULIN VLERËN E AGJËRIMIT

Është për keqardhje se si disa muslimanë të cilët agjërojnë Ramazanin, humbasin shansin ta shfrytëzojnë këtë muaj madhështor në vepra të cilat afrojnë tek Allahu, apo gjatë agjëritimit veprojnë vepra të cilat cenojnë shenjtërinë e këtij muaji, pra nuk kanë mundësi ta ruajnë veten gjatë tridhjetë ditëve të këtij muaji nga disa gabime e mëkate.

Janë disa gabime dhe mëkate të cilat përsëriten te disa njerëz Ramazan pas Ramazani dhe vazhdimisht këshilluesit (hoxhallarët) ua tërheqin vërejtjen ndaj tyre.

Prej tyre janë:

*-Pasojat, mëkatet dhe defektet e gjuhës, siç janë: gënjeshtria, përgojimi, bartja e fjalëve, debatet e polemikat e padobishme, ngritja e zërit etj. Sikur ata të mos ishin fare në Ramazan. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit, le të flasë mirë ose le të heshtë!”* Ditët e agjëritimit nuk duhet të jenë të njëjta me ditët e tjera të vitit. Agjërimi jonë nuk është në rregull, siç

kërkon Allahu dhe Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, nëse ne nuk e ruajmë gjuhën tonë. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kush nuk braktis gënjeshtren dhe të vepruarit me të dhe injorancën, le ta dijë se Allahu nuk ka nevojë që ai të braktisë ushqimin dhe pijen.”**

*-Dëfrimi, humbja e kohës dhe gjumi i tepërt.* Kjo ndodh kur sheh se si njerëzit zhyten dhe qëndrojnë për kohë të gjatë para rrjeteve sociale, TV-së, programeve denegjuese të cilat ua dëmtojnë fenë. Kështu ata nuk ruajnë shikimin e dëgjimin, joshen dhe mashtrohen pas këtyre gjërave. Allahu thotë: **“Allahu dëshiron që t’jua pranojë pendimet tuaja, por ata që jepen pas epsheve, dëshirojnë që të largoheni krejtësisht nga udha e drejtë.”** Nisa 27. Pra, duhet të ruajmë kohën e çastet e Ramazanit, duke i shfrytëzuar në gjëra të dobishme, e jo të qëndrojmë para këtyre gjërave. Të ruajmë veshët tanë nga dëgjimi i ndaluar. Të ruajmë sytë tanë nga shikimi në gjëra të ndaluara, aq më tepër në Ramazan. Shumë njerëz tregohen të pakujdesshëm ndaj shikimit e dëgjimit të gjërave të ndaluara, por

nuk e dinë se me këtë u bëhet nga një pikë e zezë, të cilat rriten e ndoshta ua mbulojnë edhe zemrat, e pastaj nuk dinë të dallojnë të mirën nga e keqja.

*-Braktisja e leximit të Kuranit, apo leximi pa meditim, vetëm me gjuhë, pa përfituar aq shumë nga ky lexim. Allahu thotë: “Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij...”* Sad 29. Të lexojmë Kuran ngadalë, mirë, ashtu siç duhet, me meditim e reflektim mbi mësimet e tij. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Nuk e kupton Kuranin ashtu siç duhet ai i cili e lexon në më pak se tre ditë.”**

*-Mosnxitimi në punë të mira, pra mjaftohen vetëm me agjërim dhe me namaz të teravive. Ndërsa, nuk nxitojnë tek aspektet e bamirësisë, apo te mëshira ndaj njerëzve të ngratë, apo te shtrimi i iftareve për nevojtarët, apo te vizitimi i të afërmve dhe të sëmurëve, apo te prezantimi në ligjërrata fetare etj. E privojnë veten nga shumëfishimi i shpërblimeve në këtë muaj.*

*-Ikja e namazit me xhemat.* Edhe ky është prej gabimeve të mëdha.

*-Mosfalja e namazit të teravive,* duke thënë se janë vetëm sunet e jo obligim. E vërtetë se janë sunet, por shpërblimi për to është shumë i madh, e nëse nuk prezanton në namazin e teravive me këtë e ke privuar veten nga një shpërblim shumë i madh që është: **“Kush falet gjatë Ramazanit (namaz të teravive) me besim dhe me shpresë (në shpërblim), atij i falen mëkatet e kaluara.”**

## MIRËSITË E SHUMTA TË RAMAZANIT

—Ky muaj ka shpërblim shumë të madh. Allahu agjërimin e këtij muaji, e ka veçuar për Vetën e Tij, siç transmetohet në një hadith kudsij se Allahu ka thënë: **“Çdo punë e birit të Ademit është për të, përveç agjërimin, ai më përket Mua dhe Unë shpërblej për të.”** Buhariu dhe Muslimi.

—Agjërimi është mburojë nga mëkatet, ashtu siç është mburojë nga zjarri. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Agjërimi është mburojë.”** Në një tjetër hadith ka thënë: **“Agjërimi është mburojë me të cilën njeriu mbrohet nga zjarri i xhehenemit.”**

—Agjërimi në këtë muaj është shkak për faljen e mëkateve. Kjo është një nga vlerat më madhështore të këtij muaji. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kush agjëron muajin e Ramazanit me besim dhe me shpresë (në shpërblim), atij i falen mëkatet e kaluara.”**

—Agjërimi në përgjithësi, si adhurim, është madhështor, i këndshëm, të cilin e përjeton shumë muslimani, e megjithatë në Ramazan kjo i shtohet

ende, për shkak të mëshirës së madhe që Allahu e zbrit në këtë muaj dhe bekimeve e begative të shumta.

—Agjërimi është nga veprat më madhështore me të cilat muslimani afrohet tek Allahu. Ebu Umame i tha të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem: *“Më urdhëro me një vepër me të cilën do të kem dobi!”* Atëherë ai salAllahu alejhi ue selem i tha: **“Mos iu ndaj agjërimit sepse nuk ka diçka sikurse ai (që mund t’i afrohet).”**

—Agjërimi do të ndërmjetësojë për muslimanin në Ditën e Gjykimit, ashtu siç do të ndërmjetësojë edhe Kurani. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka treguar: **“Në Ditën e Gjykimit agjërimi do të thotë: “O Zoti im, unë e kam penguar robin tënd nga ushqimi dhe nga epshet (gjatë ditës së Ramazanit), andaj ma mundëso të ndërmjetësoj për të!”** Pastaj do të ndërmjetësojë për të.

—Agjërimi është shkak për gëzimin dhe lumturinë e muslimanit. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Agjëruesi ka dy gëzime: njëri kur çel iftarin**

**dhe tjetri kur ta takojë Zotin e tij (dhe Ai e shpërblen për agjërimin)."**

—Aroma e pakëndshme që del nga goja dhe brendësia e agjëruetit, tek Allahu është më e mirë sesa aroma e miskut (parfumit). Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **"Pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, aroma e cila del nga goja e agjëruetit është më e mirë tek Allahu sesa aroma e miskut!"** Kjo sepse ajo del si rezultat i angazhimit me adhurim ndaj Allahut.

—Për agjëruetit në xhenet është caktuar një derë e veçantë, e cila quhet er Rejjan. Kur agjëruetit futen në atë derë, ajo mbyllet dhe askush tjetër përveç tyre nuk ka mundësi të hyjë. Fjala "Er Rejjan" rrjedh nga fjala "er rrej – ngopja, shuarja e etjes". E pa dyshim ky emër është shumë i përshtatshëm me urinë e etjen e agjëruetit që e përjeton gjatë agjërimit, gjithashtu me përmbajtjen e tij ndaj gjërave të tjera. Të gjitha këto nuk i bën për diçka tjetër veçse që të kërkojë shpërblimin e Allahut.

## FAKTORËT NDIHMUES NË SHFRYTËZIMIN E RAMAZANIT

Disa njerëz ndodh të jenë shumë energjik e aktiv në fillim të muajit, por pastaj me kalimin e ditëve kjo ambicie fillon të zbehet.

Janë disa faktorë të cilët të ndihmojnë të përfitosh (sa më shumë) në këtë muaj fisnik:

√ Të agjërosh me gëzim të madh, me zemër të hapur, me vullnet të fortë. Të dish se agjërimi i Ramazanit është obligim i pakontestueshëm dhe për mosagjërimin e tij nuk ka arsye, përveçse për ata persona të cilët i ka arsyetuar Allahu. Allahu thotë: **“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush...”** Bekare 183.

√ Të mendosh thellë rreth thesareve të çmuara që përmban ky muaj madhështor, si: falja e mëkateve të kaluara, **“Kush agjëron Ramazanin me besim dhe me shpresë (në shpërblim), i falen mëkatet e kaluara.”** Dhe: **“Kush falet gjatë Ramazanit (namaz nate, teravi) me besim dhe me shpresë (në shpërblim) i falen mëkatet e kaluara.”** Dhe: **“Kush**

**falet në natën e Kadrit me besim dhe duke shpresuar në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e kaluara.”** Pa dyshim se kjo është vlerë dhe mirësi shumë e madhe. Secili prej nesh e dëshiron faljen dhe mëshirën e Allahut.

√ Të lirohesh prej pengesave dhe angazhimeve të tepërta dhe të përgatitesh për Ramazanin me seriozitet dhe vendosmëri. Mos i hap vetes dyert e projekteve të kësaj bote, sepse ato pastaj ta rrëmbejnë kohën dhe ëmbëlsinë e këtij muaji dhe nuk të lejojnë të shijosh këtë muaj madhështor.

√ Të nxitësh vetveten drejt punëve të mira dhe të kuptosh mirë se nuk lejohet të tregohesh i shkujdesur në këtë muaj. Allahu thotë: **“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj”**. Ali Imran 133. Ramazani është sezon i faljes së gjynaheve.

√ Të shikosh të mirët dhe të devotshmit se si e shfrytëzojnë këtë muaj, që edhe ti t’iu ngjasosh atyre.

√ Të luftosh vetveten, ta mundosh atë, për të larguar nga vetja dembelinë, gjumin, shkujdesjen, kjo duke shpeshtuar përmendjen e Allahut, kërkimin e faljes

tek Ai, duke u larguar prej mexhliseve të kota, duke ruajtur syrin e veshin nga mëkatet etj.

√ Të kuptosh mirë urtësinë e ligjësimit të agjërimit, që është devotshmëria (et takua) - frika ndaj Allahut. Ibën Mesudi radijAllahu anhu thoshte: *“Devotshmëria është të bindemi ndaj Allahut e jo të tregohemi të pabindur ndaj Tij, vazhdimisht ta kujtojmë e ta përmendim Allahun dhe ta falënderojmë Atë e të mos tregohemi mosmirënjohës ndaj Tij.”* Aliu radijAllahu anhu thoshte: *“Devotshmëria është kur frikësohesh prej të Madhërishmit, kur punon me Kuran, kur je i kënaqur me pak (aq sa të ka dhënë Allahu) dhe kur përgatitesh për ditën në të cilën largohesh prej kësaj bote.”* Qëllimi i këtyre fjalëve është: të dish se je nën mbikëqyrjen e Allahut, të punosh sipas fesë së Tij, të mos shtosh gjërat e panevojshme nga jeta e kësaj bote dhe të përgatitesh seriozisht për Ditën e Kiametit. Mejmun ibn Mehran rahimehullah thoshte: *“I devotshmi (ai që ka frikë Allahun) e llogarit veten me më rreptësi sesa ortaku koprrac që e llogarit ortakun e tij.”* Andaj, nëse përmes agjërimit ti arrin të realizosh devotshmërinë, atëherë pa dyshim se ky agjërim do të të inkurajojë dhe do të

të nxisë ta përmendësh Allahun sa më shumë, të bësh vepra të mira, të kesh frikë Allahun dhe të përgatitesh për Ditën e llogaridhënies, gjithashtu bën që dunjaja të mos ketë vlerë tek ti dhe të të mos shfrytëzojë ajo ty, por ti ta shfrytëzosh atë e ta trajtosh si urë apo rrugë që të çon në botën tjetër.

## **PLANIFIKIMI PËR SHFRYTËZIMIN E RAMAZANIT PARA ARDHJES SË TIJ**

Ne duhet fillimisht të bëjmë planifikime për ardhjen e muajit të Ramazanit se si ta shfrytëzojmë atë. Kur veprojmë kështu, do të thotë se e respektojmë këtë muaj dhe se jemi përgatitur për ardhjen e tij. Kjo sepse planifikimi karakterizohet me organizim dhe saktësim për gjërat edhe më të vogla. Kjo pastaj të nxitë të mendosh e të reflektosh dhe të realizosh ato gjëra të planifikuara. Në origjinë, është që njeriu të mendojë rreth planifikimit para ardhjes së Ramazanit, e pastaj të vendosë ato që dëshiron t'i synojë dhe realizojë gjatë Ramazanit.

Gjatë Ramazanit kemi adhurime të ndryshme, si: agjërim, namaz nate, lexim të Kuranit, lëmoshë, mbajtje të lidhjeve farefisnore etj. Dhe njeriu e pyet veten: “A të fokusohem vetëm te njëri aspekt duke lër të tjerat, apo të përpiqem aq sa kam mundësi me të gjitha veprat e mira?!”

Planifikimi ka sukses nëse realizojmë disa pika, si:

› Fillimisht të pendohemi tek Allahu me sinqeritet.

› Të jemi të vendosur e të palëkundur ndaj realizimit të atyre gjërave që kemi planifikuar.

› Të largojmë pengesat e angazhimet dhe të ruajmë kohën e çmuar të Ramazanit dhe të mos lejojmë që çastet e këtij muaji të na ikin pa ndonjë dobi.

Sa i përket elementeve që përmban planifikimi për muajin e Ramazanit, janë:

—Të jemi të përkushtuar shumë në faljen e namazeve në xhami dhe në faljen e suneteve para dhe pas farzit.

—Të ndajmë një kohë të caktuar për lexim të Kuranit. Nëse dëshirojmë që këtë ta zbërthejmë në një orar ditor, kjo është siç vijon:

Falim namazin e sabahut në xhami, kryejmë dhikrin, pastaj lexojmë Kuran deri sa të lindë dielli, pas kësaj falim dy rekate dhe kthehemi në shtëpi. Falim namazin e drekës në xhami, lexojmë Kuran, lexojmë diçka nga tefsiri. Pastaj kur të vijë ikindia e falim atë dhe qëndrojmë në xhami, dhe ky është një shans i artë sepse është kohë e gjatë dhe njeriu është i liruar nga angazhimet, andaj këtë kohë e shfrytëzon për të lexuar Kuran sa më shumë apo edhe diçka nga tefsiri.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Xhamia është shtëpia e çdo besimtari.”** Në një tjetër transmetim: **“...shtëpia e çdo të devotshmi.”** Pastaj kthehesh në shtëpi (për shërbim ndaj familjes). Nëse prindi organizon një lloj ndeje për rritjen e besimit dhe ndërgjegjësimin e familjes, edhe kjo është mirë, si: ua mëson vlerat e Ramazanit, ua dëgjon leximin e Kuranit, i nxit për agjërim, për namaz nate, për bamirësi, për lutje etj.

Pastaj vjen koha e iftarit dhe namazi i akshamit. Pas kësaj ndeja me familjen. Është mirë që edhe koha pas iftarit të shfrytëzohet. Familjari/prindi merr ndonjë libër për t’ua lexuar anëtarëve të shtëpisë. Pastaj shkojnë së bashku në xhami për të falë namazin e jacisë dhe të teravive. Pas kësaj është i lirë të bëjë ndonjë vizitë (tek të afërmit, apo fqinjët). Kthehet në shtëpi dhe shfrytëzon kohën për lexim të Kuranit dhe tefsir.

Ajo që është me rëndësi është që ky orar ditor të ndërlihet me pesë namazet ditore, sepse kështu je më i saktë dhe më i rregullt.

—Të kesh synime të përgjithshme, si: shtrimin e iftareve, ndihmën e jetimëve, këshillën ndaj njerëzve nëse ke dije etj.

## VËLERA DHE RUAJTJA E KOHËS GJATË RAMAZANIT

Përse duhet ta ruajmë kohën gjatë Ramazanit? Pse u bëjmë thirrje edhe të tjerëve në këtë dhe që të kenë kujdes nga mbushja e kohës me gjëra të kota e të këqija, por që ta mbushin me vepra të mira? Janë disa arsye që na bëjnë t'i kushtojmë vëmendje kohës në përgjithësi, e në veçanti gjatë Ramazanit, si:

» Muaji i Ramazanit është prej kohëve më me vlerë, më të mira, siç transmetohet nga brezat e parë të Islamit se kanë thënë: *“Ai është zotëria i të gjithë muajve.”*

» Në Ramazan veprat e mira shumëfishohen në shpërblim dhe Allahu zbret bereqet e bekime në veprat e mira të personit.

» Njeriu duhet të përpiqet shumë gjatë Ramazanit dhe gjatë jetës ngase do të pyetet para Allahut për çdo çast të kaluar në jetën e dunjasë. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Njeriu në Ditën e Gjykimit do të pyetet për pesë gjëra”**, prej tyre përmendi **“për jetën e tij se si e ka kaluar”**. Pra, çfarë ka bërë gjatë saj, me çfarë e ka mbushur apo me çfarë

e ka shkatërruar. Çdo gjë është e shënuar dhe e ruajtur mirë, **“Allahu të gjitha i ka shënuar, edhe pse ata i kanë harruar. Allahu është dëshmitar i çdo gjëje”** Muxhadile 6, dhe: **“(Kini frikë) ditën, kur çdokush do ta gjejë përpara atë që ka punuar mirë dhe atë që ka punuar keq, duke dëshiruar që midis tij dhe së keqes së tij, të ketë largësi të madhe. Allahu ju paralajmëron që t’i ruheni Vetes së Tij. Allahu është i Butë e i Mëshirshëm me robërit e Vet.”** Ali Imran 30. Andaj, ai që e mbush kohën e Ramazanit me gjëra të këqija, le të jetë i bindur se (një ditë) do ta lërë jetën e kësaj bote prapa shpinës e do të dalë para Allahut me veprat e tij. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Të vdekurin e përcjellin tri gjëra: familja, pasuria dhe veprat e tij. Kthehen dy dhe mbetet njëra. Kthehen familja dhe pasuria e tij, ndërsa me të mbeten veprat e tij.”** Puno për Allahun, bëj punë të mira, mbush kohën me to dhe nxito drejt gjërave që të sjellin dobi, e mos u bëj sikur ata të cilët e humbasin kohën kot dhe e shkatërrojnë rininë e tyre dhe jetën e tyre.

## HAJDUTËT E VLERËS SË AGJËRIMIT TË RAMAZANIT

Muslimanët i gëzohen ardhjes së Ramazanit, agjërimit në këtë muaj dhe nxitimit drejt punëve të mira në të. Megjithatë duhet të kemi kujdes ndaj disa gjërave të cilat vazhdimisht tentojnë të rrëmbejnë këtë kënaqësi e shijim të adhurimeve gjatë Ramazanit. Nga to përmendim:

-Rrjetet sociale, programet televizive, para të cilave ulet njeriu dhe nuk e ruan shikimin e dëgjimin. Allahu thotë: **“Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara...”** Nur 30. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Birit të Ademit i është shkruar hisja e tij në imoralitet dhe ai patjetër do ta arrijë atë. Sytë bëjnë imoralitet dhe ai është shikimi (i ndaluar). Veshët bëjnë imoralitet dhe ai është dëgjimi i të ndaluarës. Imoraliteti i gjuhës është të folurit. Imoraliteti i dorës është prekja, ndërsa imoraliteti i këmbës janë hapat drejt ë ndaluarës. Ndërsa, zemra dëshiron e shpreson. Të gjitha këto i pohon (konfirmon) organi intim apo i përgënjeshton.”**

-Shokët e këqij, të cilët ta humbasin kohën kot dhe prej të cilëve nuk përfiton dobi, ndeja me ta është e mbushur me fjalë të kota e të ulëta.

-Shpenzimet dhe daljet e tepërta. Shërbimi ndaj familjes është një gjë obligative nga ana fetare. Megjithatë, në disa raste kjo teprohet dhe bën që njeriut t'ia rrëmbejë kohën pa ndonjë dobi. Ndodh të dalë në treg për të blerë disa gjëra të caktuara dhe të mbetet me orë të tëra, e pa dyshim kjo nuk i shkon Ramazanit. Nuk i ka hije muslimanit të kalojë orë të gjata në treg gjatë këtij muaji.

-Gjumi i gjatë, veçanërisht gjatë ditëve të pushimit, duke humbur kohën, pastaj shtohet dembelia dhe plogështia. Hadithi: "Gjumi i agjëruesit është adhurim" nuk është hadith i saktë. Andaj, duhet pakësuar gjumin dhe duhet sistemuar atë.

Dëmet e të gjitha këtyre janë:

-ngurtësia e zemrës,

-humbja e kohës,

-humbja e bereqetit të Ramazanit,

-ngecja në vepra të mira,

-mposhtja nga shkujdesja,

-humbja e dështimi,

-e më e rrezikshmja është humbja e shanseve për faljen e Allahut dhe arritjen e mëshirës së Tij.

## HUMBJA E KOHËS GJATË RAMAZANIT

Disa njerëz sprovohen gjatë Ramazanit duke humbur kohën pa ndonjë dobi. Kjo kohë u ikë pas gjumit, pas mbetjes mbrapa me vepra të mira, pas përtacisë etj. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Shumica e njerëzve tregohen të shkujdesur ndaj dy begative, e ato janë: shëndeti dhe koha e lirë.”** Buhariu.

Koha është një begati shumë e madhe. Nga ana tjetër, kur Allahun ta mundëson të arrish Ramazanin, kjo kërkon prej teje që të ruash kohën e tij nga humbja, këtë kohë të çmueshme.

Janë disa mënyra apo metoda që të ndihmojnë ta ruash kohën në Ramazan, si:

—(Nga ana psikike) Të reflektosh/meditosh në disa gjëra, si: në madhësinë e Ramazanit, se ky muaj kërkon vigjilencë dhe vëmendje, se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem dhe brezat e parë bënë gara drejt punëve të mira, përpiqeshin shumë në adhurime, se Ramazani kalon shumë shpejt, se ditët ikin e nuk të presin, **“Janë disa ditë të caktuara”**, të

mendosh rreth gjendjeve të atyre të cilëve u ikin shpërblimet e Ramazanit pa përfituar prej tij, të çosh ndërmend se Allahu ty ta ka mundësuar arritjen e tij dhe kjo kërkon prej teje përpjekje etj.

-Të ndihmohesh përmes shoqërimit me shokë të mirë  
- që të ndihmojnë të shfrytëzosh Ramazanin. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Njeriu është në fenë e shokut të tij.”**

-Të çosh ndërmend se çfarë ambicie të madhe kishe në fillim të Ramazanit dhe ta ruash atë ambicie nga pakësimi. Imam el Xhunejdi ka thënë: *“Ruaje ambicien e lartë që ke për vepra të mira, sepse ajo u prin gjërave.”*

-Të çosh ndërmend hadithin e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem: **“Qoftë i poshtëruar ai person i cili arrin Ramazanin dhe përfundon e atij nuk i falen mëkatet!”**

Ndërsa, metodat praktike për ruajtjen e kohës janë:

-Të kesh një musaf të veçantë për vete nga i cili lexon. T'i edukosh edhe të tjerët nga familja që të kenë edhe ata nga një musaf secili. Jepu dhuratë nga një musaf,

e kjo është nga dhuratat më të mira që mund t'ia bësh familjes tënde.

-Të qëndrosh në xhami (nëse ke mundësi) për të lexuar Kuran, sepse ndeja në xhami (p.sh. pas namazit) ta ruan kohën, dhe kështu e ruan shikimin apo dëgjimin nga gjërat të cilat e cenojnë agjërimin. Transmetohet se Ebu Hurejra dhe nxënësit e tij qëndronin në xhami gjatë Ramazanit dhe thoshin: *“Po e ruajmë agjërimin tonë.”*

-Të organizosh dhe sistemosh jetën familjare brenda shtëpisë tënde. Ka raste kur kërkesat dhe nevojat e familjes rriten, andaj organizoje veten dhe kohën tënde në atë mënyrë që kur të vijë koha e ikindisë të lirohesh nga angazhimet dhe të jesh i lirë ta hapësh musafin. Organizoj edhe lidhjen me shokët e tu, në atë mënyrë që kjo pastaj të mos ndikojë tek koha jote në Ramazan dhe në përgjegjësitë fetare. Përpiqu të jesh produktiv në shoqërinë ku jeton, duke organizuar iftare për agjëruarit, duke ndihmuar të tjerët, duke ua lehtësuar vështirësitë etj.

Ajo që është më e rëndësishmja, është që vazhdimisht të kërlesh prej Allahut të të ndihmojë në kryerjen e punëve të mira.

## DISA NGA DOBITË E AJETEVE TË AGJËRIMIT

Do të përmendim disa nga dobitë që kanë të bëjnë me ajetet e agjërimit të Ramazanit, të cilat i ka përmendur Allahu në Kuran.

► Allahu thotë: “O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të bëheni të devotshëm. Agjërimi zgjat disa ditë, por, nëse ndonjëri prej jush është i sëmurë ose duke udhëtuar, le të agjërojë aq ditë sa i ka prishur në ditët e tjera pas. Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi. E, nëse ndonjëri jep më shumë se kaq, kjo është edhe më mirë për të. Por, agjërimi juaj është më i dobishëm, në qoftë se e dini.” Bekare 183-184. Në këtë ajet madhështor kemi disa dobi shumë të rëndësishme, si:

—“që të bëheni të devotshëm”. Kjo na bën të kuptojmë se cila është urtësia kryesore, më e lartë dhe më madhështore e ligjësimit të agjërimit, që është *arritja e devotshmërisë*, gjë e cila pastaj na nxit të jemi të përrulur, të nënshtruar, që i përmbahemi urdhrave

të Allahut, që largohemi nga çdo gjë të cilën e ka ndaluar Ai dhe që mes nesh dhe dënimit të Tij vendosim një mburojë e cila na ruan. Kjo (devotshmëria) arrihet duke kryer obligimet dhe duke u larguar prej ndalesave. Si arrihet kjo gjë përmes agjërimit? A arrihet me çdo lloj të agjërimit? Pa dyshim që jo. Por, arrihet vetëm me agjërime të saktë, të pastër, me agjërime të cilat qëndronin mbi përvetshësinë dhe nënshkrimin e plotë ndaj Allahut, me agjërime gjatë të cilat njeriu ruan gjymtyrët e tij nga ndalesat dhe largohet nga gjërat e ulëta e të këqija. Andaj, kujdes që këtë adhurim madhështor (agjërime) të mos e devijosh nga ajo për të cilën e ka ligjësuar Allahu, duke vepruar të kundërtën, sepse kështu pastaj nuk do të gesh gjurmët e tij në jetën tënde.

—**“agjërime gjatë disa ditë”**. Ai është një muaj brenda vitit i cili përbëhet nga dymbëdhjetë muaj, e pa dyshim se një muaj në krahasim me njëmbëdhjetë të tjerë është shumë pak. Pastaj, këto ditë nuk të presin - kalojnë shumë shpejt, andaj duhet t'i shfrytëzosh, duhet të nxitosh drejt punëve të mira e të mos jesh i

shkujdesur. Allahu thotë: **“por, nëse ndonjëri prej jush është i sëmurë ose duke udhëtuar, le të agjërojë aq ditë sa i ka prishur në ditët e tjera pas.”**

Bekare 184. Në këtë ajet Allahu ka hequr obligimin e agjërimit për personin e arsyetuar me sëmundje dhe udhëtarin. Këta të dy e prishin agjërimitin pastaj e kompensojnë pas Ramazanit. Dhe: **“Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi.”**

Bekare 184. El Ale rahimehullah përmend se kur Allahu e ka ligjësuar në fillim agjërimitin e muajit të Ramazanit, njeriu ka qenë i lirë të zgjedhë të mos agjërojë e pastaj të ushqejë një të varfër ose të agjërojë, megjithatë agjërimi ishte më mirë. Personi i cili nuk agjëronte, edhe pse kishte mundësi, ishte i detyruar të ushqente një të varfër, e nëse ushqente më shumë se një të varfër kjo ishte më mirë për të, porse nuk ishte i obliguar me kompensim të agjërimit, ndërsa nëse agjëronte kjo ishte më mirë, për shkak të fjalës së Allahut: **“Por, agjërimi juaj është më i dobishëm, në qoftë se e dini.”** Pastaj, Allahu e anuloi këtë ajet dhe mbeti (i ligjësuar) për të moshuarit e thyer në

moshë dhe për të sëmurin me sëmundje të rëndë (kronike) që nuk mund të agjërojë (sëmundja ia vështirëson shumë agjërimin), siç transmetohet kjo nga Ibn Abbasi radijAllahu anhu dhe të tjerë prej sahabëve.

► Allahu thotë: **“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja).”** Bekare 185.

—**“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani”**. Në këtë pjesë të ajetit Allahu tregon se Kurani ka zbritur në muajin e Ramazanit, mirëpo a do të thotë kjo se ka zbritur vetëm në Ramazan dhe se pjesët e tjera nuk kanë zbritur edhe në muajt e tjerë të vitit? Përgjigja është se Kurani ka zbritur nga Leuhi Mahfudh në formë të kompletuar te Bejtul izze (në qiellin e kësaj bote), pastaj pjesë-pjesë ka zbritur te Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, varësisht nga ngjarjet dhe rrethanat me të cilat janë përballur muslimanët.

—“që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)”, d.m.th.: kush beson Kuranin, ai e udhëzon në jetën e tij dhe e mbron nga shtigjet dhe rrugët e devijimit, ashtu siç thotë Allahu në suren Isra: “Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira...” ajeti 9. Në Kuran ka shenja që tregojnë për udhëzim, që orientojnë drejtë udhëzimit të Allahut, duke ia bashkëngjitur kësaj se ai është dallues i së vërtetës nga e pavërteta, dallues i udhëzimit nga devijimi. Ky ajet tregon për vlerën e madhe që ka Ramazani dhe se ai është veçuar nga muajt e tjerë me zbritjen e Kuranit. Ky ajet na jep shenjë se ekziston një lidhje e ngushtë mes agjërimit dhe Kuranit. Agjërimi nuk është ashtu siç kërkohet nëse njeriu nuk lexon Kuran, apo nuk e përsërit atë, apo nuk mediton rreth tij. Përmendet se Xhibrili vinte te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem gjatë muajit të Ramazanit dhe së bashku e mësonin Kuranin çdo natë, ndërsa në vitin në të cilin vdiq ai, Xhibrili i erdhi dy herë. Andaj, dalim në përfundim se Ramazani është muaji i Kuranit, i studimit të tij. Gjithashtu

duhet të lexojmë mbi biografinë e brezave të parë të Islamit, që të shohim se si ata ishin të përkushtuar në leximin e Kuranit dhe përfundonin hatme pas hatme. Megjithatë, edhe nëse ne lexojmë biografinë e tyre të ndritur dhe se sa shumë kanë lexuar ata Kuran në Ramazan e sa shumë vepra të mira kanë bërë, kjo nuk do duhet të na thyejë ambiciet e vendosmëritë tona, mirëpo ne duhet të përpiqemi t’iu ngjasojmë atyre, në seriozitet, në nxitim drejt punëve të mira, në ruajtjen e kohës dhe në shpeshimin e punëve që afrojnë tek Allahu. Duhet të kemi kujdes nga gjumi i tepërt e nga humbja e kohës sepse Ramazani është shans i dhënë nga Allahu dhe ndodh që të jetë i fundit për ty. Andaj, duhet bërë kujdes ndaj shkujdesjes dhe humbjes së çasteve të tij të arta.

Nga dobitë e tjera të cilat Allahu i përmend tek ajetet e agjërimin, janë:

► Allahu thotë: “...kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t’jua lehtësojë dhe jo që t’jua

**vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë.”** Bekare 185.

—Ky është argument se agjërimi i Ramazanit është obligim madje shtyllë prej shtyllave të Islamit, për atë person i cili e arrin këtë muaj dhe nuk është i sëmurë apo udhëtar.

— **“Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar”**. Je i lirë të vonosh agjërimin e atyre ditëve, përderisa të mos hyjë Ramazani i vitit të ardhshëm, sepse në të kundërt pastaj së bashku me agjërimin duhet të japësh ushqim (për shkak të shkujdesjes). Gjithashtu je i lirë të kompensosh ato ditë ngjitur njëren pas tjetrës apo dhe mund t’i ndash në ditë të caktuara, sipas mendimit të saktë të dijetarëve.

— **“Allahu dëshiron që t’jua lehtësojë dhe jo që t’jua vështirësojë”**. Allahu fillimisht ia lejoi të sëmurit dhe udhëtarit që të kompensojnë ditët e pa agjëruara pasi

të përfundojë Ramazani. Pastaj e konfirmoi këtë çështje duke treguar se feja e Tij është e lehtë, është mëshirë, dhe se Ai nuk e ngarkon askënd përtej aftësisë e mundësisë që ka ai. Madje, nëse shikojmë ligjshmërinë e Ramazanit dalim në përfundim se ai është i lehtë, dhe kjo nga disa aspekte: 1. Është vetëm një muaj brenda tërë vitit, 2. Agjërohet dita e jo nata, 3. Lejohet freskimi me ujë, shtrirja për gjumë etj.

— **“Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë.”** Kuptimi i përgjithshëm i këtij ajeti është: pasi besimtarët plotësojnë agjërimin e muajit Ramazan, pastaj në fund bëjnë tekbire (duke thënë Allahu ekber) për ta madhëruar Allahun. Kjo pjesë e ajetit është baza apo origjina e cila tregon për tekbiret e Fitër Bajramit. Tekbiret fillojnë nga perëndimi i diellit në natën e Bajramit deri kur fillon namazi i Bajramit. Madje, disa dijetarë kanë thënë se kjo pjesë e ajetit na bën të kuptojmë se tekbiret e Fitër Bajramit janë më të

konfirmuara fetarisht sesa tekbiret e Kurban Bajramit.

— **“që ta falënderoni Atë”** d.m.th.: Allahu ua mundësoi të arrini Ramazanin, pastaj agjërimin e tij, shfrytëzimin e ditëve të tij duke kryer sa më shumë vepra të mira, e jetuat kënaqësinë e agjërimin, çeljes së iftarit e ngrënies së syfyrit dhe bëtë adhurime të tjera të ndryshme, andaj të bëheni falënderues ndaj Tij. Allahu thotë: **“Ne do t’i shpërblejmë mirënjohësit”** dhe: **“Ne i shpërblejmë ata që falënderojnë”**. Dije se falënderimi ndaj Allahut bëhet me gjuhë, me zemër dhe me gjymtyrë.

Në mesin e ajeteve të agjërimin është dhe një ajet i mrekullueshëm e i mahnitshëm, i cili ka të bëjë me çështjen e lutjes drejtuar Allahut.

► Allahu thotë: **“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.”** Bekare 186.

Në këtë ajet kemi disa dobi:

—Kur Allahu përmendi çështjen e lutjes brenda ajeteve që trajtojnë agjërimin, me këtë dha shenjë për vlerën e madhe që ka lutja drejtuar Atij dhe për rëndësinë ndaj kujdesit për të bërë lutje, veçanërisht në Ramazan, gjatë çeljes së iftarit, në namazin e teravive dhe në natën e Kadrit- sepse ajetet (në mesin e të cilëve është ky ajet që sollëm) flasin për tematikën e agjërimit. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem thoshte: **“Lutja drejtuar Allahut është pikërisht adhurimi.”** Adhurimi themelor, bazik. Dhe ka thënë: **“Vërtetë Zoti juaj është i turpshëm dhe shumë bujar, që jep shumë. Ai turpërohet që robi i Tij të ngrehë duart drejt Tij e Ai t’ia kthejë pa asgjë.”** Në Ramazan përgjigja ndaj lutjeve ka pozitë edhe më të veçantë, për shkak të vlerës dhe rëndësisë së kohës (së Ramazanit). Porse, njeriu duhet t’iu kushtojë vëmendje disa kushteve dhe edukatave karshi lutjes drejtuar Allahut. Prej tyre janë: ta lusë Allahun me zemër të pranishme, ta lusë me Emrat e Tij të bukur dhe Cilësitë e larta, të mos ushqehet me gjëra të

ndaluara, të mos lutet me lutje që përmbajnë në vete mëkat, të ngrehë duart gjatë lutjes etj.

—Allahu është afër atij i cili e lut Atë, siç thotë: **“Unë jam afër”**. Njeriu është më së afërmi me Allahun kur të bie në sexhde gjatë namazit, andaj Ai na ka udhëzuar që t’i shpeshtojmë lutjet (në sexhde).

—Përgjigja jonë ndaj Allahut duke kryer obligimet dhe duke u larguar nga ndalesat e Tij, është shkak që të udhëzohemi në rrugën e drejtë.

► Allahu thotë: **“Tani është e lejuar për ju që, gjatë netëve të agjërimit, të shkoni me bashkëshortet tuaja.”** Bekare 187

—Allahu ka lejuar kontaktin intim mes bashkëshortëve në netët e Ramazanit. Kjo na jep shenjë se në fillim të Islamit kjo ishte e ndaluar, ngase kur ishte ligjësuar agjërimi i Ramazanit, agjërimi fillonte prej pas namazit të jacisë deri në perëndimin e diellit të ditës tjetër, e nëse ndodhte që njeriu të flinte para namazit të jacisë atëherë prej aty i fillonte agjërimi dhe së bashku me kontaktin intim i ndaloheshin edhe gjërat e tjera (ushqimi, pija).

Transmetohet se nëse ndonjëri prej sahabëve ishte agjërueshëm dhe vinte koha e iftarit, mirëpo flinte para se të hante, atëherë përmbahej nga ushqimi deri në perëndimin e diellit të ditës së radhës. Përmendet ngjarja e sahabiut esh shuar Kajs ibn Sirme el Ensari i cili ishte agjërueshëm dhe kur erdhi koha e iftarit shkoi të bashkëshortja e tij për të kërkuar ushqim, por nuk kishte çfarë t'i jepte, andaj doli të kërkonte diçka për të, mirëpo ky sahabi punonte shumë gjatë ditës (lodhej) dhe derisa ishte duke pritur ushqimin e mori gjumi. Kur erdhi bashkëshortja dhe e pa në atë gjendje, tha: "I mjeri ti!" Sepse e dinte se tani do të duhej të agjëronte deri në të nesërmen kur perëndon dielli. Ai nesër doli të punonte sepse ishte njeri punëtor, mirëpo në mesditë u lodh e u rraskapit shumë, andaj humbi ndjenjat. Kur ia përmendën këtë gjë Pejamberit salAllahu alejhi ue selem, atëherë Allahu zbriti këtë ajet, me të cilin ua lejoi ushqimin, pijen dhe kontaktin intim gjatë natës. Pastaj sahabët iu gëzuan shumë këtij ajeti.

► Allahu thotë: **“Mos iu afroni atyre (bashkëshorteve) gjatë kohës kur mbylleni për adhurim në xhami!”** Bekare 187

—Ky ajet na tregon për dispozitën e itikafit dhe se ai priset me kontaktin intim dhe me gjëra që i paraprijnë (kontaktit intim). Itikafi është izolimi në xhami në shenjë adhurimi ndaj Allahut duke kryer sa më shumë vepra të cilat afrojnë tek Allahu (siç është dhikri, leximi i Kuranit, lutjet etj.). Është sunet dhe e rekomandueshme që itikafi të bëhet në Ramazan, aq më tepër në dhjetë ditët e fundit (duke kërkuar natën e Kadrit). Itikafi është nga sunetet e braktisura në kohën në të cilën po jetojmë. Madje, edhe nëse ka që futen në itikaf, vërejmë se te një pjesë e tyre mungon forma sheriatike e saktë e tij, siç është: qëndrimi në xhami dhe mosdalja nga ajo përveçse për raste të nevojshme, thellimi në përmendjen e Allahut, angazhimi me dhikër e me lexim të Kuranit, mosbërja e bisedave të kota e dytësore që nuk i përkojnë gjendjes së personit që është futur në itikaf për të adhuruar Allahun. Kohëzgjatja më e vogël e itikafit siç përmendin dijetarët është një ditë, ndërsa

sipas mendimit të tyre kushtëzohet që të jetë agjërueshëm në atë ditë.

## **NXITIMI I BESIMTARËT NË VEPRA TË MIRA GJATË RAMAZANIT**

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka treguar në një hadith se në natën e parë të Ramazanit një thirrës thërret:

**"O të që synon të mirën, nxito dhe angazhohu në vepra të mira!"**

Drejt çfarë gjëje të nxitojë? Të nxitojë:

-Drejt mirësive të shumta në këtë muaj madhështor.

-Drejt veprave të llojllojshme të cilat afrojnë tek Allahu.

-Drejt mëshirës së Allahut e cila mbulon njerëzit në këtë muaj, sepse siç tregon Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem: **"Allahu liron shumë njerëz nga zjarri në çdo natë të Ramazanit."**

-Drejt agjërimit, që është vepër e pashoqe edhe nuk mund të krahasohet me veprat e tjera. E kanë pyetur të Dërguarin salAllahu alejhi ue selem: *"Më urdhëro me një vepër me të cilën Allahu do të më sjellë dobi?"* Atëherë i ka thënë: **"Përmbaju agjërimit sepse nuk**

**ka diçka të ngjashëm me të!" Gjithashtu ka thënë në një hadith: "Agjërimi është mburojë ndaj zjarrit të xhehenemit."**

-Drejt lutjeve tek Allahu, sepse i tërë Ramazani është sezon i bekuar gjatë të cilit Allahu u përgjigjet lutjeve, e veçanërisht gjatë çeljes së iftarit siç ka treguar Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem se për agjëruesin në ato momente është një lutje e pa refuzuar.

-Drejt leximit të Kuranit fisnik, sepse muaji i Ramazanit është muaji i Kuranit, "**Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani**", Bekare 185. E agjërimi nuk mund të jetë i këndshëm, siç dëshiron muslimani, pa e përmendur Allahun e pa lexuar Fjalët e Tij.

-Drejt namazit të natës - teravive. Allahu i ka lavdëruar ata që ngrihen nga gjumi, e sakrifikojnë atë, vetëm e vetëm që ta lusin Atë e të falen natën, "**Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë**" Sexhde 16. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "**Kush falet gjatë Ramazanit**

(fal namaz të teravive) **me besim dhe me shpresë në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e kaluara.**”

Dhe: **“Kush falet së bashku me imamin derisa të përfundojë namazi i natës, i shkruhet se është falur tërë natën.”**

-Drejt bujarisë, dorëdhënies - u jep të tjerëve, shtron iftare, ushqen të varfrit, ndihmon nevojtarëve, tregon mëshirë ndaj njerëzve të ngratë që kanë vështirësi e gjendje të rënda.

-Drejt adhurimeve, që nuk mund t'i kryejë jashtë këtij muaji, adhurime të shumta, ai i shijon siç nuk i ka shijuar më parë.

Të gjitha këto e bëjnë të jetë serioz e të nxitojë drejtë punëve të mira dhe të shfrytëzojë këtë shans të artë (Ramazanin), të cilin ia ka dhuruar Allahu i Lartësuar.

## TËRHEQJA E BESIMTARIT NGA TË KËQIJAT NË RAMAZAN

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem na ka treguar se në natën e parë të Ramazanit një thirrës thërret:

**“O ti që synon të keqen, tërhiqu!”**

Njeriu i cili nuk tërhiqet nga të këqijat as në Ramazan, kur do të tërhiqet prej tyre?!

Ky hadith është argument se njeriu ka dëshirë dhe vullnet, të cilat pastaj e nxisin të veprojë të këqija apo të synojë të mirën. Kuptimi i kësaj pjese të hadithit është: O ti që synon të keqen, përmbaje veten, tërhiqu, mos nxito drejt të këqijave në Ramazan dhe turpërohu prej Allahut.

Pason pyetja: Përse njeriu të tërhiqet nga të këqijat në Ramazan? Kjo për disa arsye:

-Ramazani është sezon i mirësive, shumë i vlefshëm, në të cilën shtohen në peshë punët e këqija, ashtu siç shtohen në peshë edhe punët e mira dhe mirësitë që i bën muslimani.

-Shejtanët prangosen dhe shpirtrat e njerëzve janë më afër punëve që afrojnë tek Allahu.

-Dyert e xhenetit hapen dhe dyert e xhehenemit mbyllen. Kjo bën që njeriu të nxitojë drejtë punëve të mira dhe të kërkojë të mirën.

-Muaji i Ramazanit, nga fillimi deri në fund, është i mbushur me mirësi, me bekime e bereqete të shumta, të cilat gjithsesi muslimani duhet t'i shfrytëzojë e assesi nuk i lejohet t'i humbasë ato apo të tregohet neglizhues ndaj tyre. Drejt këtij kuptimi, Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem dha shenjë në një hadith kur tha: **“Qoftë i poshtëruar (i nënçmuar) ai person i cili arrin Ramazanin dhe e mbaron atë dhe nuk i falen mëkatet!”**

-Ramazani me vetë atmosferën e tij që ka, bën që njeriu të turpërohet më shumë prej Allahut e të ketë shpirt më të qetë i cili nuk e nxit drejt mëkateve. Ai person i cili nuk ka turp ndaj Allahut gjatë jetës së tij, atëherë së paku le të turpërohet në Ramazan, ngase gjatë tij shejtanët janë të lidhur e të prangosur dhe

shpirtrat e njerëzve janë të etur e të përmalluar për mirësinë e Allahut dhe mëshirën e Tij.

-Njeriu duhet të tërhiqet nga të këqijat në Ramazan, në mënyrë që të mos futet te grupi i shejtanëve (nga xhindët e njerëzisë), apo në grupin mëkatarëve të mëdhenj, të cilët nuk i zbraps as Ramazani e asnjë sezon i mëshirës dhe mirësisë dhe të cilët kanë larguar nga vetja petkun e turpës. Ki kujdes e mos u fut në grupin e tyre! Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Nga fjalët që kanë trashëguar njerëzisë prej profetësive të lashta, është fjala “Nëse nuk turpërohesh, vepra çfarë të duash!”** Buhariu.

## **PENDIMI DHE KTHIMI TEK ALLAHU NË RAMAZAN**

Sa gjë e bukur është që njeriu të pendohet gjatë Ramazanit! Sa gjë e bukur është që t'i pranojë mëkatet e tij e të kthehet tek Allahu gjatë këtij sezoni madhështor e fisnik! Ai nuk duhet ta humbasë shpresën në Mëshirën e Allahut, sado që ka bërë mëkate në të kaluarën. Allahu thotë: **“O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut!”** Zumer 53.

Pse pendimi është aq i mirë dhe i këndshëm gjatë Ramazanit? Kjo për disa arsye:

-Lind në një sezon të mbushur me mirësi e vlera të mëdha.

-Personi që pendohet në Ramazan, këtë pendim e themelon mbi vendosmëri të fuqishme dhe përpjekje të madhe nga aspekti i besimit.

-Atmosfera shpirtërore në Ramazan nxit njeriun të pendohet dhe e bën të jetë i qëndrueshëm e i kapur fort për fenë e Allahut, gjë që e shohim të gjithë gjatë Ramazanit.

Andaj, nëse nuk pendohesh në Ramazan, kur do të pendohesh?! Kur pret të pendohesh?!

Vazhdimisht kujto Mëshirën e madhe të Allahut, Faljen e Tij të gjerë, pastaj shiko vlerat e mëdha të Ramazanit i cili është një sezon madhështor dhe begati e mirësi e madhe. Sado të kesh bërë mëkate e vepra të liga, kthehu tek Allahu, nxito me pendim për tek Ai, shfaqe istigfarin tënd, ndërpriti mëkatet e bëra deri tash dhe tregohu i sinqertë dhe i vërtetë me Allahun gjatë Ramazanit, sepse ndodh të jetë Ramazani i fundit për ty. Allahu thotë: **“Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.”** Ta he 82.

Në suren Furkan, Allahu përmend krime e mëkate të tmerrshme, pastaj në fund thotë: **“Përjashtim bën ai që pendohet, beson dhe punon vepra të mira. Një njeriu të tillë Allahu ia ndërron veprat e këqija në të mira. Allahu është Falës e Mëshirëplotë.”** Furkan 70.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem në një hadith kudsij tregon se Allahu ka thënë: **“O biri i Ademit, përderisa më lut Mua dhe shpreson tek Unë, Unë do t’i fali mëkatet e tua... O biri i Ademit, edhe nëse mëkatet e tua arrijnë kupën qiellore e pastaj kërkon falje prej Meje, Unë të fali...”** Allahu kërkon prej teje vetëm pendimin dhe kthimin tek Ai, singërisht dhe me vërtetësi.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem në një hadith kudsij tregon se Allahu ka thënë: **“O robërit e Mi, ju bëni mëkate gjatë natës dhe ditës dhe Unë i fali të gjitha mëkatet, mirëpo kërkonte falje prej Meje e Unë ju fali.”** Ai salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Allahu shtrin dorën e Tij gjatë natës që të pendohet ai që ka bërë mëkate ditën dhe shtrin dorën e Tij gjatë ditës që të pendohet ai që ka bërë mëkate natën, kjo derisa dielli të lindë nga perëndimi.”**

Nga hadithet madhështore që tregojnë për Mëshirën e Allahut, është ai që tregon rastin e një gruaje e cila pas një beteje që kishte ndodhur kërkon fëmijën e saj, e kur e gjen e shtrëngon, e përqafton dhe fillon ta

ushqejë me gji. Atëherë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem u thotë shokëve të tij: **“A mendoni se kjo grua do ta hidhte fëmijën e saj në zjarr?”** Thanë: *“Jo, assesi.”* Ai tha: **“Allahu është më i Mëshirshëm ndaj robërve të Tij sesa kjo gruaja ndaj fëmijës së saj.”**

Jeto me këto ajete e hadithe, silli ndërmend ato, e megjithatë mos u trego i shkujdesur ndaj gjendjes tënde dhe mos i humb çastet e vlefshme të Ramazanit (në vepra jo të mira e të kota).

## ZEKATI GJATË RAMAZANIT

—Njerëzit tregohen të kujdesshëm që zekatin e tyre zakonisht ta nxjerrin në Ramazan, edhe pse ndodh që u bëhet obligim para ardhjes së tij. Pa dyshim se kjo është gabim. Ajo çfarë është obligim është që muslimani të nxjerrë zekatin posa t'i bëhet obligim dhënia e tij. Megjithatë, nëse ndodh që nxjerrja e zekatit të tij të qëllojë në Ramazan, atëherë në rregull.

—Ka njerëz që tregohen të shkujdesur në dhënien e zekatit, nganjëherë e japin e nganjëherë nuk e japin, apo nëse e japin nuk e llogarisin mirë. Pa dyshim edhe kjo është gabim.

—Duhet të dimë se zekati është shtyllë e Islamit, shtyllë e fortë e tij. Andaj, nuk na lejohet të tregohemi të shkujdesur ndaj tij. Ai është e drejtë që u takon një pjese të shoqërisë. Zekati ka dobi të shumta ngase ndërlidh shoqërinë muslimane mes veti, mban lidhjet e forta mes muslimanëve, e bën shoqërinë islame si një ndërtesë solide, të fortë dhe të qëndrueshme. Zekati është shkak që njeriut t'i shtohet pasuria dhe që Allahu t'i japë bereqet në

pasuri. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Lëmosha nuk pakëson asnjëherë pasurinë.”**

—Pasuritë prej të cilave është obligim të nxjerrët zekati janë:

-Paratë, të cilat janë tri lloje: ar, argjend dhe monedha (të hollat e letrës). Allahu thotë: **“Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm. Do të vijë dita, kur (thesaret e mbledhura) do të digjen në zjarrin e Xhehenemit dhe me to do të damkoset balli, anët dhe shpina e tyre e do t’u thuhet: “Kjo është ajo që keni grumbulluar për veten; pra, shijoni atë që grumbulluat!”** Teube 34-35.

-Sasia e arit (nisabi) si zekat është: 85 gram.

-Sasia e argjendit si zekat është: 595 gram.

Pastaj, nga kjo sasi, qoftë ar apo argjend, është obligim të nxirret 2.5%.

—Mallrat apo artikujt për tregti e shitblerje. Çdo gjëje që tregtohet dhe shitet për të përfituar prej saj, duhet

t'i nxjerrët zekati. Nxjerrja e zekatit të tyre: Duhet të vlerësosh çmimin e tyre me çmimin real në kohën kur obligohet nxjerrja e zekatit për to (pa shikuar se sa ka qenë çmimi kur i ke blerë ato). Pastaj, çmimin real aktual e bën bashkë me fitimin e tyre (i cili ka qenë rezultat i tregtisë së tyre), dhe në fund nxjerr 2.5% nga e gjithë kjo.

—Drithërat që dalin nga toka. Nisabi (sasia e caktuar) e tyre është 653 kg.

—Bagëtitë: devetë, lopët, delet dhe dhitë. Kusht për zekatin e tyre është kullosja në pjesën më të madhe të vitit, nëse jo atëherë nuk ka zekat për to. Për devetë nisabi është 5 copë. Për lopët është 30 copë. Për delet apo dhitë është 40 copë. (Nëse personi ka kaq copë e më shumë, e ka obligim zekatin e tyre).

\*Kur njeriu arrin nisabin e këtyre llojeve të pasurive, atëherë i bëhet obligim dhënia e zekatit për to.

## THYERJA E NEFSIT GJATË RAMAZANIT

Do të flasim lidhur me rëndësinë e madhe që ka pendimi gjatë muajit të Ramazanit, sepse ky muaj është një shans i artë që të pendohemi tek Allahu. Kur njeriu është i ngopur dhe në shkujdesje (gaflet), kjo bën që ai të dëshirojë të kryejë mëkate. Ndërsa, kur është i uritur dhe duke agjëruar për hir të Allahut, kjo bën që shpirti i tij të thyhet, të jetë i gatshëm për pendim dhe të pranojë mëkatet e bëra. Kjo është pra natyra e Ramazanit.

Disa prej dijetarëve kanë thënë: *“Kush lë barkun zbrazur, edhe mendimet e tij do të jenë më madhështore dhe zemra e tij do të jetë më vigjilente (do të jetë njeri më mendjemprehtë).”* Dhunun el Misri rahimehullah ka thënë: *“Sa herë që jam ngopur, i kam bërë mëkat Allahut apo e kam dëshiruar këtë.”*

Njeriu është më afër pendimit gjatë Ramazanit për shkak të disa gjërave, si:

-Ndjehet më i thyeshëm shpirtërisht dhe më i gatshëm drejt punëve të mira.

-Shpirti i tij është më i qëndrueshëm ndaj të vërtetës dhe rrugës së drejtë.

-Në Ramazan është i kufizuar ndikimi i shejtanëve te njerëzit (ngase ata janë të lidhur me zinxhirë).

Njerëzit e shohin një gjë si problematike dhe thonë: “Nëse thoni se shejtanët janë të lidhur gjatë Ramazanit, atëherë si ka mundësi të ndodhin të këqijat gjatë Ramazanit, madje ndodh edhe të shtohen?”

Përgjigja:

“Aspekti i parë: Lidhja me zinxhirë e shejtanëve është e veçantë vetëm për shejtanët kryeneç, e jo për të gjithë, siç është saktësuar në një hadith të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem ku përmendet se ai ka thënë: **“Në natën e parë të Ramazanit lidhen në zinxhirë e pranga shejtanët kryeneç.”** Aspekti i dytë: Të këqijat gjatë Ramazanit pakësohen nëse njeriu agjëron me një agjërim që plotëson kushtet dhe rregullat e agjërit, që do të thotë: nëse agjërimi është i saktë, edhe shpirti i agjëruarit do të jetë i mirë dhe të këqijat e tij do të pakësohen, në të kundërt jo.

Aspekti i tretë: Të këqijat pakësohen, e jo se nuk ndodhin fare.”

Ne nxisim të gjithë që të pendohen tek Allahu e të kthehen me pendim tek Ai gjatë këtij sezoni madhështor e fisnik. Allahu thotë: **“O ju, që keni besuar! Kthehuni tek Allahu me një pendim të sinqertë”**. Tahrir 8.

Pendimi i sinqertë përmban tri kushte:

1. Të heqësh dorë menjëherë prej mëkatit.
2. Të kesh vendosmëri të fortë e të vërtetë se nuk do t'i kthehesh atij mëkati.
3. Të ndihesh keq që e ke bërë. Pejagmberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Të ndihesh keq (keqardhja) për mëkatin e bërë është pendim.”** Nëse njeriu ndihet keq për mëkatin që ka bërë dhe pikëllohet për kohën dhe pasurinë e shpenzuar në ndalesë/mëkat, atëherë ai është në mirësi, e nëse zhytet në mëkate ka mundësi që kjo ndjesi të zbehet e të fiket brenda tij.

Për shkak të rëndësisë dhe vlerës së pendimit tek Allahu, dijetarët kanë përmendur disa nga dobitë e tij, si:

-pendimi ripërtërinë besimin, e shton atë, e forcon lidhjen me Allahun,

-pendimi mundëson të shpëtosh dhe të triumfosh në këtë botë dhe tjetrën,

-pendimi bën të ndjesh lumturi në shpirt,

-pendimi është shkak që Allahu ta dojë njeriun dhe të gëzohet për pendimin e tij, **“Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen”**. Bekare 222.

-kur njeriu pendohet, Allahu ia shndërron punët e këqija në punë të mira.

## **RINGJALLJA DHE RIPËRTËRITJA E SUNETEVE TË PEJGAMBERIT SALALLAHU ALEJHI UE SELEM**

Meqë Ramazani është sezon i ripërtëritjes së besimit tonë dhe se besimi është i kufizuar brenda Kuranit e sunetit, pa dyshim se Ramazani është rast i artë që të ringjallim sunetin e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dhe të fitojmë shpërblim të madh nga kjo. Allahu thotë: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm...”** Ahzab 21. Dhe: **“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.”** Hashr 7.

Të jesh i bindur se nuk ke mundësi të hysh në xhenet veçse përmes rrugës së Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem edhe nëse shpeshton veprat e mira dhe bindjen ndaj Allahut.

Nga sunetet brenda Ramazanit përmendim:

◆ Shpeshtimi i leximit të Kuranit, **“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani”**. Bekare 185. Përmendet në hadithe se Xhibrili e vizitonte Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem çdo

natë të Ramazanit dhe së bashku mësonin Kuranin. Nga kjo kuptojmë se është e pëlqyeshme të shpreshtojmë leximin e Kuranit në Ramazan, në veçanti gjatë natës, sepse atëherë zakonisht njeriu është i liruar nga angazhimet, ka ambicia më të fortë dhe gjuha i bashkëvepron me zemrën (leximi i Kuranit i ndikon më shumë).

◆ Shpejtimi dhe çelja e iftarit posa të perëndojë dielli. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Njerëzit do të vazhdojnë të jenë mirë (të kapur për feje) përderisa shpejtojnë iftarin.”** Po ashtu, çelja e iftarit me hurma të njoma, nëse nuk ka atëherë me hurma të tjera, nëse nuk ka hurma atëherë me ujë.

◆ Lutja gjatë iftarit. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Secili musliman ka një lutje që i pranohet gjatë Ramazanit.”** Dhe: **“Allahu e pranon lutjen e muslimanit kur çel iftarin.”** Është prej sunetit që kur të çelim iftarin të themi lutjen:

ذَهَبَ الظَّمُّ وَأَبْتَلَّتِ العُرُوقُ، وَتَبَّتْ الأَجْرُ إِنْ شَاءَ اللهُ

**“U largua etja, u njomën (lagën) venat dhe mbeti shpërblimi me lejen e Allahut!”**

Ndërsa, hadithi: “O Allah, për ty kam agjëruar dhe me furnizimin tënd e çeli iftarin!” është hadith i dobët në zinxhirin e tij.

◆Leximi i dhikrit të mbrëmjes, pastaj bërja e lutjeve për çfarëdo që dëshiron (për veten apo për muslimanët).

◆Vonimi i syfyrit dhe zgjimi në të (duke mos e anashkuar). Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Hani syfyr sepse në të ka bereqet.”** Në një hadith, syfyrin e quajti ushqim të bekuar nga Allahu. Dhe në një hadith tjetër ka përmendur se syfyri është kriter ndarës mes agjërimit tonë dhe agjërimit të Ithtarëve të Librit (krishterëve dhe hebrenjve).

◆Ngrënia e hurmave në syfyr. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Sa syfyr i mirë është hurma për besimtarin!”**

◆Kujdesi ndaj faljes së namazit të teravive. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kush falet me imamin derisa të përfundojë, i shkruhet se është falur tërë natën.”** Dhe: **“Kush falet gjatë Ramazanit (teravi, namaz nate) me besim (në**

**Allahun) dhe me shpesë (në shpërblimin e Tij), i falen mëkatet e kaluara.” Ky është një sunet i fortë i cili gjallëron zemrën, bën që të meditosh në ajetet që dëgjon, bën që të kesh zemër të përulur ndaj Allahut, dhe kjo pastaj të mëson të jesh i durueshëm gjatë gjithë kohës, edhe jashtë Ramazanit.**

◆Përdorimi i miswakut apo i brushës së dhëmbëve. Kjo është e pëlqyer si për agjëruesin si për joagjëruesin. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Sikur mos ta rëndoja umetin tim, do ta urdhëroja të përdornin miswakun para çdo namazi.”** Në një hadith tjetër ka thënë: **“... në çdo abdes apo para çdo abdesi.”** Dhe ka thënë: **“Miswaku pastron gojën dhe kënaq Zotin.”**

◆Shtrimi i iftareve për agjëruesit. Ky është një sunet madhështor për të cilin tregon hadithi i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem: **“Kush i jep iftar agjëruesit, do të ketë shpërblimin sikur të atij pa iu pakësuar asgjë nga shpërblimi (i agjëruesit).”** Kjo bën pjesë te bujaria, dorëdhënia dhe shpenzimi i pasurisë për muslimanët gjatë Ramazanit. Është e pëlqyeshme të shpeshtohet shtrimi i iftareve dhe të

gjenden njerëz nevojtarë, jetimë, vejusha, të divorcuara dhe kategori të ngjashme (për t'iu shtruar iftare).

◆Thënia “**Unë jam agjërueshëm**” ashtu siç na ka mësuar Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem nëse dikush të ofendon e të grindet, apo do të polemizojë. Kjo është një armë që posedon, me të cilën mbrohesh nga gjërat e ulëta, edukohesh, ruan qetësinë dhe ndërpret rrugën e shejtanit, në mënyrë që ajo kacafytje (përmes gjuhës) mos të zgjasë dhe të mos bëhet shkak për dobësimin e shpërblimit të agjërimit.

## **NAMAZI I NATËS (TERAVITË) GJATË RAMAZANIT**

Namazi i natës është nga adhurimet apo namazet më të mira e më të vlefshme pas atyre obligative. Allahu, duke lavdëruar ata besimtarë që falen gjatë natës, thotë: **“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.”** Sexhde 16-17. Dhe: **“Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu).”** Dharijat 17-18. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, duke iu treguar sahabëve për vlerën që ka namazi i natës, ka thënë: **“Jini të rregullt në faljen e namazit të natës, ngase ky ishte zakoni i njerëzve të mirë para jush. Ai (namazi i natës) të afron tek Allahu e të ndalon nga gjynahet dhe largon sëmundjen nga trupi.”** Dhe: **“Kush falet gjatë natës me dhjetë ajete, nuk shkruhet në atë natë nga radhët e të shkujdesurve.”**

Nga rregullat që duhet t'i kemi parasysh lidhur me namazin e natës, janë:

-Pëlqehet të fillohet me dy rekate të lehta, të shkurta, për shkak të hadithit të Aishes që transmetohet te Buhariu ku tregohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem kur falte namaz gjatë natës, fillonte me dy rekate të shkurta e të lehta.

-Pëlqehet që namazi i natës të hapet me lutje të transmetuara nga Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem.

-Pëlqehet të zgjatet e të falet në formën më të mirë të mundshme. Aisha radijAllahu anha duke treguar se si falej Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem gjatë natës, ka thënë: *“Falte katër rekate. Mos pyet se sa të bukura e sa të gjata ishin.”*

-Pëlqehet të falet dy nga dy (fal dy rekate jep selam, pastaj fal dy të tjera), për shkak të fjalës së Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem i cili ka thënë: **“Namazi i natës është dy nga dy.”**

-Pëlqehet që namazi i natës të përmbillet me namazin e vitrit (rekate tek). Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Namazin tuaj të fundit**

**gjatë natës bëjeni tek.”** Kishte për qëllim faljen e namazit të vitrit.

-Pëlqehet shpeshtimi i lutjeve dhe këmbëngulja në lutjet drejtuar Allahut. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Gjatë natës është një orë, të cilin nëse muslimani rastis t’ia qëllojë duke kërkuar prej Allahut ndonjë mirësi të kësaj bote apo të botës tjetër, veçse Allahu ia jep atë, dhe kjo është për çdo natë.”**

-Pëlqehet të pastrohet goja me miswak për namaz të natës apo me brushë të dhëmbëve. Kështu ishte tradita e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem.

-Pëlqehet të zgjatët rukuja e sexhdeja dhe të thuhen lutje e dhikre që i thoshte Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem në to.

-Pëlqehet që kur të lexohen ajetet ku përmendet ndëshkimi i Allahut, të kërkojmë mbrojtje tek Ai prej Tij, apo kur të lexohen ajetet ku përmendet mëshira e Allahut e xheneti, të kërkojmë prej Tij të na mëshirojë e të na mundësojë Xhenetin, apo kur të lexohen ajetet

ku përmendet lavdërimi e lartësimi i Allahut, ta lavdërojmë e ta lartësojmë Atë.

-Lejohet sipas konsensusit të dijetarëve që namazi i natës të falet ulur edhe nëse personi ka mundësi të falet duke qëndruar në këmbë.

## **NA MAZFALËSIT E NATËS DHE SHPËRBLIMI I TYRE**

Nga adhurimet më madhështore gjatë Ramazanit është edhe namazi i teravive apo namazi i natës, i cili është një sunet shumë i fortë, ndaj të cilit nuk duhet të tregohemi assesi të shkujdesur.

≈Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem thotë: **“Kush falet gjatë Ramazanit, me besim dhe me shpresë (në shpërblimin e Allahut), i falen mëkatet e kaluara.”**

Ky hadith është bazë për pëlqyeshmërinë e faljes së namazit të natës gjatë Ramazanit. Ky hadith na tregon se falja e namazit të natës dhe teravive gjatë Ramazanit, është një portë prej nga të vjen falja e Allahut dhe mëshira e Tij dhe është rrugë për të fituar xhenetin. Namazi i natës si gjatë Ramazanit si jashtë tij, ka dobi, vlera e mirësi të shumta.

≈Allahu, duke lavdëruar ata që falen natën, ka thënë: **“Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu).”** Dharijat 17-18. Dhe: **“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë”**. Sexhde 16. Ky ajet na tregon se ata janë njerëz që falen, që bëjnë dhikër, që lexojnë Kuran e që

luten gjatë natës dhe që flenë pak gjatë saj, ndryshe nga gjendja jonë sot.

≈Dhe thotë: **“Natyrisht, adhurimi natën vepron më fuqishëm dhe fjala është më shprehëse”**. Muzemil 6. Domethënë: kur njeriu falet dhe lexon Kuran gjatë natës, në këtë mënyrë zemra bashkëvepron me gjuhën, andaj zemra kupton dhe i pranon më shumë ajetet që lexon, në këtë rast ndikohet më shumë sesa kur i lexon gjatë ditës, e pastaj dobitë e njohuritë nguliten më shumë në zemër.

≈Hadithi tjetër që na tregon për vlerën e madhe që ka namazi i natës është: **“Vazhdimisht faluni gjatë natës (mos e humbisni atë), sepse ky ishte zakoni i njerëzve para jush. Namazi i natës iu afron te Zoti juaj, ua shlyen mëkatet, largon sëmundjen nga trupi dhe zbraps nga mëkatet.”** Ky hadith përmbledh disa dobi të namazit të natës: na tregon se ishte shprehësi dhe zakoni i njerëzve të mirë para nesh, se është lidhje e fortë me Zotin, se shlyen të këqijat, se të jep shëndet në trup dhe të ndalon prej veprave të ulëta e të këqija.

≈Hadithi tjetër ku thuhet: **“Kush falet me imamin derisa të përfundojë namazin, i shkruhet se është falur tërë natën.”**

≈Hadithi tjetër në të cilin tregohet se ka ardhur një njeri te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem dhe i ka thënë: *“Nëse dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se ti je i Dërguari i Allahut, fali pesë kohët e namazit, agjëroj Ramazanin dhe falem gjatë tij (namaz nate, teravi), ku do të jem?”* Atëherë i ka thënë: **“Do të jesh me të sinqertit dhe dëshmorët.”**

≈Po ashtu hadithi që e transmeton Buhariu dhe Muslimi ku thuhet: **“Kush falet në natën e Kadrit me besim dhe me shpresë (në shpërblimin e Allahut), i falen mëkatet e kaluara.”** Gjallërimi i natës së Kadrit me namaz arrihet kur fal namazin e teravive së bashku me muslimanët apo në shtëpi. Është mirë të përmendim se gjallërimi i kësaj nate bëhet me namaz, me dhikër e me lutje. Nata e Kadrit është gjëja më madhështore të cilën njeriu e kërkon brenda dhjetë netëshit të fundit të Ramazanit.

## RAMAZANI MUAJI I KURANIT

Ramazani është edhe muaji i Kuranit, i leximit të tij, i meditimit në të dhe i nxjerrjes së dobive prej tij. Agjërimi i njeriut nuk mund të jetë i këndshëm pa lexim të Kuranit, pa përmendjen e Allahut, pa lutjet drejtuar Atij.

Ramazani është muaji i Kuranit ngase Kurani ka zbritur në Ramazan. Ibn Abbasi radijAllahu anhu ka thënë: *“Kurani ka zbritur nga Leuhi Mahfudh – Pllaka e ruajtur mirë, në shtëpinë Bejtul Izze, në qiellin e kësaj bote, gjatë muajit të Ramazanit në Natën e Kadrit.”* Allahu thotë: **“Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar”**. Duhan 3. Dhe: **“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit”**. Kadr 1.

Për muslimanin agjërues është e pëlqyeshme që gjatë këtij muaji t’i kthehet Kuranit. Allahu duke e lavdëruar Kuranin dhe duke treguar pozitën e lartë që ka ai, thotë: **“Pa dyshim që Kurani është krenari për ty dhe popullin tënd; e ju do të pyeteni!”** Duhan 44. Kurani është burim i krenarisë dhe mburrjes për çdo musliman.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e përsëriste Kuranin çdo natë me Xhibrilin alejhi ue selem gjatë Ramazanit.

Nëse muslimani i kthehet Kuranit me vërtetësi e seriozitet dhe përpjekje të shumtë në leximin e tij dhe meditimin në të, kjo përbën një lloj garimi në punë të mira, siç thotë Allahu: **“bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira”** Bekare 148.

Brezat e parë të muslimanëve i përkushtoheshin tërësisht Librit të Allahut duke e lexuar dhe duke meditar rreth tij, kjo ngase ata e dinin vlerën dhe madhësinë e Kuranit, dinin fuqinë që përmbajnë fjalët e tij, që janë Fjalët e Zotit të botëve, fjalët më të mira, më të vërteta, më të pastra. Uthmani radijAllahu anhu thoshte: *“Sikur zemrat tona të ishin të pastra, nuk do të ngopeshin me Fjalët e Allahut.”* Ata përfundonin hatme pas hatme, numër të madh të hatmeve, gjatë Ramazanit. Kjo na jep të kuptojmë se sa serioz që ishin, sa përpjekje të mëdha bënin në leximin e Kuranit dhe se çfarë ambicie të larta kishin në leximin e Librit të Allahut.

## RAMAZANI- SHKOLLË E KURANIT

Prej bekimeve e bereqeteve brenda Ramazanit, është se Allahu atë e ka bërë si një shkollë e cila të mëson se si duhet të meditosh mbi Kuranin. Ramazani është shkollë e cila të afron me Kuranin dhe bën që të përfitosh prej mësimëve që përmban ai.

Qëllimi i zbritjes së Kuranit është të meditosh e reflektosh mbi ajetet e tij, e jo vetëm ta lexosh me gjuhë. Allahu thotë: **“Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të mendarët”**. Sad 29. Dhe: **“Vallë, a nuk përsiatin ata për Kuranin apo i kanë zemrat të kyçura?!”** Muhamed 24.

Kush arrin këtë ëmbëlsi (meditim mbi Kuranin), Allahu ia mundëson të arrijë besimin e mirëfilltë, ia gjallëron zemrën dhe ia pastron shpirtin, dhe pastaj do të bëhet prej njerëzve më të mençur, do të dijë të dallojë të mirën nga e keqja dhe të vërtetën nga e kota. Për këtë arsye, sa më shumë që mediton rreth Kuranit dhe reflekton rreth vargjeve të tij, kjo shton dashurinë dhe respektimin ndaj Kuranit dhe bën që

të jesh më i kapur për feje. Gjëra të tilla nuk mund të arrihen veçse kur angazhohesh me Kuran.

Janë disa hapa që të arrish deri te përsiatja dhe meditimi mbi Kuranin, prej tyre:

-Të lexosh Kuranin ngadalë, qartë, qetë, pa nxituar.

-Të kesh njohuri të përgjithshme mbi shpjegimet e Kuranit.

-Të ecësh vazhdimisht në këtë mënyrë, e jo të tregohesh i shkujdesur.

-Të reflektosh lidhur me kuptimin e ajeteve që lexon, që pastaj të dalësh me dobi madhështore nga leximi i Kuranit.

## GRUAJA MUSLIMANE GJATË RAMAZANIT

Çdo tekst fetar që na nxit drejt punëve të mira dhe në largimin nga mëkatet, është i përgjithshëm si për burrat si për gratë (me përjashtim nëse ekziston ndonjë argument i cili i veçon). Edhe gruaja muslimane duhet të zbatojë urdhrat e Allahut dhe të largohet nga ndalesat. Prej saj kërkohet një gjë e tillë ashtu siç kërkohet edhe prej burrave.

Muslimanja e ka obligim të agjërojë Ramazanin kur të hyjë në moshën madhore (me njërin prej shenjave që janë të njohura).

Edhe gratë duhet të nxisin drejt punëve të mira gjatë Ramazanit, të falënderojnë Allahun që ua ka mundësuar ta arrijnë atë dhe duhet të shfrytëzojnë këtë shans madhështor. Allahu thotë: **“...bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira”**. Bekare 148. Dhe: **“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit”**. Ali Imran 133. Kjo i përfshin sikur burrat ashtu edhe gratë.

Gruaja ka mundësi që edhe ajo të garojë me burrat drejt punëve të mira, drejt dijes fetare, drejt

adhurimeve të ndryshme, drejt përmendjes së Allahut, drejt lëmoshës etj. Ajo që është me rëndësi është që të përpiqet dhe të punojë punë të mira. Allahu thotë: **“Për këtë (shpërblim), le të përpiqen ata që përpiqen.”** Mutafifin 26.

Gruas muslimane i lejohet të jetë e pranishme në namazin e teravive, mirëpo me kusht që ta ketë mbulesën ashtu siç duhet, të mos mbajë aromë (parfum) e cila u shkakton fitne meshkujve dhe që të mos lërë ndonjë obligim (mangët) në shtëpinë e saj të cilin duhet ta përmbushë (si: kujdesi dhe edukimi i fëmijëve).

Gruaja muslimane duhet të ketë parasysh gratë e mira të devotshme para saj dhe t'i marrë për shembull, si: Aishen, Khadixhen, Fatimen, Asijen etj. Ishin pikërisht veprat e tyre të mira të cilat e bënë të përjetshëm përmendjen e tyre përgjatë historisë.

Gruaja muslimane duhet të ketë kujdes që agjërimin e saj ta ketë të saktë dhe ashtu siç duhet, të largohet nga defektet e gjuhës (gënjeshtër, përgojimi, bartja e fjalëve etj.), të angazhohet me përmendjen e shpeshtë

të Allahut, me dëgjimin e ligjëratave islame, me dëgjim të Kuranit, edhe nëse është duke i bërë punët e shtëpisë.

Ajo mund të përpiqet në dhënien lëmoshë, në shtrimin e iftareve për agjëruesit, në ushqyerjen e të varfërve etj.

Nga ana tjetër, janë disa gjëra prej të cilave duhet të ruhet gruaja muslimane, si:

-të mos shpeshtojë vizitat, sepse ato ia humbasin kohën e çmuar të Ramazanit,

-të mos e braktis shtëpinë e saj për kohë të gjatë sepse kjo çon në gjëra jo të mira,

-të mos tregohet e shkujdesur ndaj hixhabit, veçanërisht kur del për në xhami,

-të mos angazhohet së tepërmi me punë të shtëpisë sepse kjo ka pasojë shkujdesjen ndaj punëve të mira (dhikrit, leximit të Kuranit etj.).

## DISA EDUKATA PËR BESIMTARIN GJATË RAMAZANIT

Agjërimi i muajit Ramazan nuk mund të jetë ashtu siç duhet e siç kërkohet nga Allahu nëse është i zhveshur nga edukata dhe disa rregulla të caktuara. Ato ia shtojnë hijeshinë agjërimin dhe shfaqin bukurinë që përmban ai. Prej tyre janë:

❁ Sinqeriteti për Allahun, el ikhlas. Allahu thotë: **“...adhuro vetëm Allahun me përkushtim të çiltër për Të!”** Zumer 2. Patjetër agjërimi ynë duhet të jetë me sinqeritet për Allahun, për hir të Tij, jo të agjërojmë sepse po agjërojnë banorët e vendit tonë. Sinqeriteti është kusht për pranimin e çdo adhurimi ndaj Allahut.

❁ Besimi dhe shpresa, që do të thotë: të agjërojmë duke qenë të bindur se Allahu e ka bërë obligim muajin e Ramazanit dhe duke shpresuar në shpërblimin e Tij. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kush agjëron muajin e Ramazanit me besim dhe me shpresë (në shpërblim), atij i falen mëkatet e kaluara.”**

✿ Nxitimi në vepra të mira. Allahu thotë: “...**bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira**”. Bekare 148.

✿ Ruajtja e gjuhës nga defektet e saj, si: gënjeshtër, përgojimi, bartja e fjalëve etj. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “**Kushdo që nuk e braktis gënjeshtërën dhe të vepruarit me të dhe injorancën, le ta dijë se Allahu nuk ka nevojë që ai të braktisë ushqimin dhe pijen.**”

✿ Thënia “Unë jam agjërueshëm!” kur dikush të shan, të ofendon, të lëndon, kur tenton të polemizojë me ty, apo të grindët me ty. Kur e thua atë (rrjedhimisht) ia kujton edhe tjetrit, në mënyrë që të dy të zbrapseni e të mos futeni në gjëra të këqija. Kjo pa dyshim bën që pastaj t’i përmbahesh edukatës dhe qetësisë gjatë agjërimit. Le të mos jenë të njëjta ditët e agjërimit tonë sikur ditët e tjera të vitit.

✿ Solidarizimi me njerëzit e varfër, t’iu ndihmojmë atyre, t’iu shtojmë iftare etj. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem thoshte: “Kush i jep iftar agjëruesit do ta ketë shpërblimin sikur të **tij, pa ia pakësuar shpërblimin e agjërimit.**”

✽ Shpejtimi i iftarit dhe vonimi i syfyrit. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem thoshte: **“Njerëzit do të vazhdojnë të jenë mirë përderisa shpejtojnë iftarin...”** Posa të perëndojë dielli ta çelim iftarin (mos ta vonojmë). **“...dhe e vonojnë syfyrin.”** E vonojnë deri pak para se të hyjë koha e namazit të sabahut.

✽ Çelja e iftarit me hurma të njoma. Transmetohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e çelte iftarin me hurma të njoma para se ta falte namazin e akshamit e nëse nuk kishte, atëherë me hurma më të pjekura e nëse nuk kishte as prej tyre, atëherë pinte ujë.

✽ Falja e namazit në kohën e vet. Të mos lejojmë assesi që gjumi të bëhet shkak që të na ikë namazi. Allahu thotë: **“...namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar”**. Nisa 103. Ta falim edhe namazin e teravive, të falemi së bashku me muslimanët, të arrijmë vlerën e madhe të namazit të natës, të mos tregohemi të shkujdesur ndaj kësaj. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kush falet me imamin (në namazin e teravive) derisa ai të përfundojë, i shkruhet se është falë gjatë gjithë natës.”**

## RAMAZANI ËSHTË MUAJI I BUJARISË

Ramazani është shkollë e cila na mëson mëshirën ndaj të tjerëve, ai forcon lidhjet ndërmjet muslimanëve, andaj nëse dëshiron të jesh prej bujarëve në muajin Ramazan, ashtu siç ishte i Dërguari salAllahu alejhi ue selem, atëherë duhet të shfrytëzosh çastet e këtij muaji në aspektin e bujarisë e dorëdhënies dhe të jesh njeri që u ndihmon të tjerëve. Ibn Abbasi radijAllahu anhu ka treguar: *“I Dërguari salAllahu alejhi ue selem ishte njeriu më bujar e më dorëlibër, dhe kjo i shfaqej më së shumti në Ramazan.”*

Disa njerëz, edhe nëse janë bujarë e dorëlibër gjatë Ramazanit, këtë e bëjnë me gjëra të pakta e të vogla, ngase shpirtin e kanë të lidhur pas pasurisë. Nuk duhet të jemi të tillë. Gjatë Ramazanit duhet të lirojmë dorën. Përcillet nga brezat e parë të Islamit se kur vinte Ramazani thoshin: *“Erdhi ai që fshin mëkatet, andaj lirojeni dorën!”*

*Pse të tregohemi bujarë e dorëlibër gjatë Ramazanit? Kjo për disa arsye:*

-për të pasuar Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem i cili në Ramazan bëhej edhe më bujar dhe më i mëshirshëm,

-sepse gjatë Ramazanit shumëfishohen shpërblimet për punë të mira, si: dhënia iftar për agjëruesit e varfër, siç gjejmë në një hadith: **“Kush i jep iftar agjëruesit do të ketë shpërblimin e njëjtë me të, pa iu pakësuar asgjë nga shpërblimi.”**

-sepse zemrat janë të hapura dhe nxitojnë drejt punëve të mira,

-sepse lëmosha korrigjon defektet që bëhen brenda agjërimit,

-sepse ka njerëz të cilët kanë nevojë të madhe për ndihmë (si: në lagje, në qytet etj.).

Megjithëkëtë, bujaria në Ramazan nuk kufizohet vetëm te dhënia e pasurisë. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem nuk ishte bujar vetëm me pasuri, por me të gjitha llojet e bujarisë (ndihmonte njerëzit me trupin e tij, me pasurinë e tij, me dijen e tij etj.).

Muslimani duhet të tregohet njeri produktiv gjatë Ramazanit, të jetë aktiv, të marrë pjesë në projekte bamirësie, me aq sa ka mundësi, e jo të shtojë gjumin apo dembelinë.

## **I DËRGUARI I ALLAHUT GJATË RAMAZANIT**

Secili musliman ka dëshirë të madhe të dijë se si ishte gjendja e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem gjatë agjërimit të Ramazanit, të njihet me mënyrën se si agjëronte ai, se si ishte udhëzimi i tij në këtë muaj, ngase e dimë se askush nuk mund të hyjë në xhenet dhe të ketë sukses në të dy botët veçse përmes rrugës së tij salAllahu alejhi ue selem (duke e ndjekur atë). Allahu thotë: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm...”** Ahzab 21. Dhe: **“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut”** Nisa 80.

Do të përmendim disa pika se si ishte gjendja e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem gjatë Ramazanit:

—Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem së pari përgatitej shumë para ardhjes së Ramazanit dhe i përgëzonte shokët e tij për ardhjen e këtij muaji, në mënyrë që t’i nxiste të jenë sa më të përgatitur në aspektin shpirtëror dhe psikik para se të vinte ai.

—Gjatë Ramazanit atij i shtohej bujaria dhe dorëdhënia. Ibn Abbasi radijAllahu anhu ka treguar: *“I Dërguari salAllahu alejhi ue selem ishte njeriu më bujar e më dorëlibër, dhe kjo i shfaqej më së shumti në Ramazan kur e takonte Xhibrilin.”* Madje e ngjatoi atë me erën e cila bart shiun me vete - që bartë mirësi të shumta, sikur shiu që përfshin të gjitha krijesat.

—Pejamberi salAllahu alejhi ue selem e kishte gjuhën të angazhuar me dhikër dhe me lexim të Kuranit. Madje, Xhibrili e vizitonte çdo natë në Ramazan dhe e përsërisnin Kuranin.

—Bujaria e tij nuk kufizohej vetëm me pasuri, mirëpo ndihmonte njerëzit me dijen e tij (e përhapte atë), me trupin e tij etj.

—Tek ai, Ramazani ishte muaj i seriozitetit, i dorëdhënies, i punës, i luftës, madje beteja e Bedrit dhe çlirimi i Mekës kanë ndodhur pikërisht në Ramazan, dhe kjo na jep të kuptojmë se Ramazani nuk është muaj i gjumit e i dembelisë. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem në këtë muaj shtonte punët e mira.

—Netët e Ramazanit tek ai ishin të mbushura me namaz të natës, me studim dhe përsëritje të Kuranit me Xhibrilin, madje i nxiste shokët e tij duke iu thënë: **“Kush falet gjatë Ramazanit (namaz nate, teravi) me besim dhe me shpresë (në shpërblim) i falen mëkatet e kaluara.”** Pastaj u thoshte: **“Kush falet me imamin derisa ai të largohet, i shkruhet se është falur tërë natën.”**

—Ushqimi i tij gjatë Ramazanit nuk dallonte nga ditët e tjera. Ai nuk përgatitej me ushqime të shumta, siç veprojmë ne sot, mirëpo ushqimi i tij ishte i zakonshëm sikur në muajt e tjerë.

—Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i nxiste shokët e tij t’iu shtrojnë iftare agjëruesve nevojtarë, që njerëzit të ndjenjë rëndësinë e bashkimit, mëshirës dhe solidaritetit. Ai salAllahu alejhi ue selem ka thënë në një hadith: **“Mëshirojini ata që janë mbi tokë, do t’iu mëshirojë Ai që është mbi qiell.”**

## GJENDJA E SHPIRTIT GJATË RAMAZANIT

Edhe shpirtrat ndryshojnë shumë gjatë Ramazanit. Kjo ngase Ramazani ka një atmosferë shpirtërore madhështore. Nefsi nxiton shumë drejt punëve të mira dhe largohet nga punët e këqija. Ne kryejmë punë të mira edhe gjatë muajve të tjerë të vitit, madje çdo ditë, e megjithatë vërejmë se kryerja e tyre gjatë Ramazanit ka një shije tjetër, të veçantë.

Kur muslimani kryen punë të mira në Ramazan ngrehet lartë shpirtërisht dhe ndjen lumturi. Ai kryen adhurime të njëpasnjëshme, thellohet në adhurime, pa u mërzhitur, dhe kënaqet me përmendjen e Allahut. Allahu thotë: **“...ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”** Rad 28.

Kryen vepra të shumta gjatë Ramazanit e megjithëkëtë ndjen se nuk është ngopur, sikur diçka nga brenda e nxit të shtojë ende, dhe kështu ripërtërihet shpirti i tij dhe ndryshojnë ndjenjat e tij.

Kjo ndodh për shkak të disa faktorëve të cilët ndikojnë që shpirti i njeriut të ndryshojë gjatë Ramazanit, si:

~**Agjërimi.** Ai të ndalë e të zbrapsë nga epsheet e ndryshme dhe ta ruan gjuhën nga defektet e saj. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Agjërimi është mburojë.”** Dhe: **“Agjërimi është mburojë me të cilën njeriu mbrohet nga zjarri i xhehenemit.”**

~**Vetë ardhja e Ramazanit.** Shpirti i gjallë nuk mund të tregohet i shkujdesur ndaj hadithit madhështor i cili e nxjerr njeriun nga angazhimet ditore, nga gjumi dhe shkujdesja: **“Në natën e parë të Ramazanit, prangosen djajtë dhe xhindët e rebeluar, mbyllen të gjitha dyert e zjarrit të Xhehenemit dhe asnjë nuk mbetet hapur, pastaj hapen dyert e Xhenetit dhe asnjë nuk mbetet mbyllur. Një thirrës thërret: “O ti që kërkon të mirën, angazhohu me punë të mira! O ti që synon të keqen, zbrapsu nga punët e këqija! Allahu për çdo natë të Ramazanit liron shumë njerëz nga zjarri i Xhehenemit.”**

~**Garimi në punë të mira** gjatë Ramazanit, ndjenja nxitëse përbrenda për vepra të mira, ambicia e ndezur për të ndryshuar. Aq më tepër kur e dimë se në Ramazan është Nata e Kadrit për të cilën Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kush privohet prej sa është privuar nga çdo e mirë.”**

~**Në Ramazan sheh se si njerëzit nxitojnë drejt veprave të mira**, sheh xhamitë të mbushura me njerëz, dëgjon zëra duke lexuar Kuran, e pa dyshim se leximi i Kuranit sjell vigjilencën te njeriu dhe largon gjumin e shkujdesjen.

~ **Ramazani thyen egon**, epshin, përzë shejtanin, largon punët e këqija etj. Andaj, si rezultat i kësaj njeriut i vjen turp t’i bëjë mëkat Allahut, ngaqë e di se në këtë muaj janë hapur dyert e mëshirës, janë mbyllur dyert e zjarrit dhe janë prangosur djajtë. Si rezultat i kësaj, shpirti i besimtarit pastrohet dhe gdhendet dhe del prej Ramazanit me një shpirt të bardhë, të ri i, i cili është afër punëve të mira dhe urren gjërat shkatërruese e gjynahet, i cili do lidhjen me njerëzit e afërt dhe me farefisin e tij, i cili do bujarinë dhe ndihmën ndaj të tjerëve e të tilla, ashtu

siç ishte dhe Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem siç tregon ibn Abbasi për të: *“Ai ishte njeriu më bujar dhe bujaria e tij shfaqej më së shumti gjatë Ramazanit.”*

## DHJETËSHJA E FUNDIT E RAMAZANIT

Nuk ka dyshim se dhjet ditët e fundit të Ramazanit janë ditët më të çmuara të këtij muaji, janë ditët më të këndshme në jetën e njeriut dhe janë shans madhështor për atë që është treguar i shkujdesur në fillim të muajit, në mënyrë që pastaj të korrigjojë vetveten e t'i kompensojë ato që i kanë ikur në fillim a në mes të muajit.

Këto dhjetë ditë janë përgëzim për njeriun serioz i cili është treguar i përkushtuar gjatë gjithë muajit në shfrytëzimin e tij dhe në shpeshimin e shumëfishimit e shpërblimit të tij, e pastaj ta përmbyllë këtë muaj ashtu siç është më së miri.

Aisha radijAllahu anha ka treguar për gjendjen e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem gjatë këtyre dhjetë ditëve. Ajo ka thënë: *“Pejgamberi saAllahu alejhi ue selem përpiqej shumë në adhurim, shtrëngonte rripin e tij, largohej nga kontakti intim me gratë e tij, e ngjallte tërë natën me adhurim dhe zgjonte dhe anëtarët e familjes.”*

Prej kësaj fjale përfitojmë disa dobi:

-duhet të përpiqemi shumë gjatë këtyre ditëve,

-të tregohemi më serioz (më të përkushtuar) sesa në ditët e fillimit apo të mesit të Ramazanit, që të arrijmë bereqetin e këtyre ditëve,

-është mirë që të pakësohen në këto ditë edhe gjërat që janë të lejuara,

-i zoti i shtëpisë duhet t'iu kushtojë vëmendje anëtarëve të familjes së tij t'i këshillojë, që edhe ata të jenë bashkëpjesëmarrës në mirësitë e shumta të Ramazanit.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem përpiquej shumë në këto dhjetë ditë sepse pikërisht në to është nata e Kadrit, dhe siç është transmetuar, më së shumti shpresohet që ajo të jetë gjatë netëve teke të këtyre dhjetë netëve.

## **ITIKAFI DHE DISPOZITAT E TIJ GJATË RAMAZANIT**

Fjala itikaf në kuptimin fetar do të thotë: Qëndrimi në xhami, izolimi në të, për të adhuruar Allahun sa më shumë dhe për t'u afruar tek Ai sa më shumë.

Itikafi zakonisht kryhet në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, në të cilat është nata e Kadrit - nata më e vlefshme e vitit.

Itikafi është nga udhëzimi i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dhe është sunet i bashkëshorteve të tij dhe shokëve të tij. Itikafi sot është bërë sunet i braktisur në mesin e njerëzve dhe shohim se shumë pak praktikohet nëpër xhamitë tona.

Muslimani ka nevojë të izolohehet (në xhami) e të vetmohet dhe ta ripërtërijë besimin e tij nga gjërat që e njollosin atë.

Itikafi ka rëndësi të madhe për muslimanin ngase e edukon atë drejt sinqeritetit dhe kthimit tek Allahu.

Realiteti i itikafit është vetmimi e izolimi në xhami nga angazhimet e përditshme dhe përqendrimi vetëm në adhurime.

Itikafi lejohet të bëhet në çdo xhami në të cilën falet xhumaja, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve. Lejohet në çdo kohë, mirëpo më e mira është të kryhet gjatë Ramazanit, e aq më shumë në dhjetë ditëshin e fundit të tij.

Dhe sipas asaj që transmetohet nga Aisha radijAllahu anha është gjithashtu kusht që t'i paraprijë edhe agjërimi. Ajo ka thënë: *“Nga suneti, është që kur dikush dëshiron të hyjë në itikaf, të jetë agjërueshëm.”*

Itikafi fillon në dhjetë ditëshin e fundit të Ramazanit, para se të përfundojë dielli në natën 21 të muajit Ramazan, dhe personi del nga itikafi pas perëndimit të diellit të ditës së fundit të Ramazanit. Nuk lejohet dalja nga xhamia për personin i cili është në itikaf, përveçse për ndonjë nevojë, si: ushqimi, kryerja e nevojave fiziologjike apo ndonjë nevojë tjetër që i shfaqet në përditshmëri.

Gjatë itikafit personi duhet të përpiqet shumë në kryerjen e adhurimeve ndaj Allahut, të lexojë sa më shumë Kuran, të përmendë Allahun, të falë namaz

vullnetar (përveç farzeve), të prezantojë në ligjërata fetare etj.

Nuk lejohet që itikafi të shndërrohet në vend e ndejë ku këmbehen biseda e vizita, sepse kjo nxjerr nga kuptimi për të cilin besimtari ka hyr në itikaf.

Gruas i lejohet të hyjë në itikaf nëse i jep leje bashkëshorti, nëse ndihet e sigurt nga fitneja dhe nëse tregohet e kujdesshme ndaj rregullave fetare.

Çfarë e prish itikafin? Ai prishet nga kontakti intim, apo kur personi del nga xhamia pa ndonjë nevojë të domosdoshme. Ndërsa, nëse ejakulon në gjumë në xhami apo del jashtë xhamisë për ndonjë nevojë, kjo nuk e prish itikafin, megjithatë posa të kryejë nevojën që ka duhet të kthehet menjëherë në xhami.

## NATA E KADRIT

Arritja e kësaj nate madhështore është shpresë dhe dëshirë për secilin musliman. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem duke përgëzuar shokët e tij ka thënë: **“Në të vërtetë u erdhi ky muaj (Ramazani)! Në të është një natë e cila është më e mirë se një mijë muaj. Kush privohet prej saj është privuar nga çdo e mirë.”** Dhe: **“Kush falet natën e Kadrit (namaz nate, teravi), me besim dhe shpresë, do t’i falen mëkatet e kaluara.”**

**A ishte e njohur Nata e Kadrit te Profetët dhe popujt para nesh?**

Kanë ardhur hadithe siç transmeton imam Maliku të cilat thonë se kjo natë është e veçantë vetëm për umetin e Muhamedit salAllahu alejhi ue selem. Megjithatë, në hadithin e Ebu Dherrit që e transmeton Nesaiu, i cili ka zinxhirë më të mirë, përmendet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë se kjo natë ka qenë edhe te Profetët e tjerë. Dijetari i madh islam ibn Uthejmini rahimehullah në librin “Mexharis Ramazan” bën bashkë mes këtyre haditheve duke thënë se vlera e kësaj nate është e

veçantë vetëm për umetin e Muhamedit salAllahu alejhi ue selem.

Kjo natë pa dyshim se është brenda Ramazanit dhe është në dhjetë netëshin e fundit, në një nga netët teke, për shkak të haditheve të shumta në të cilat urdhërohet që kjo natë të kërkohet pikërisht në netët teke në dhjetëshen e fundit të Ramazanit. Netët në të cilat më së shumti shpresohet të jetë kjo natë janë netët teke, dhe prej netëve teke më së shumti shpresohet nata e njëzetë e shtatë, siç është mendimi i shumicës së dijetarëve, megjithatë ajo zhvendoset (lëvizë) prej një nate në tjetrën (nuk është gjithmonë në të njëjtën natë).

### **Cila është urtësia e fshehjes së kësaj nate?**

Transmetohet se një ditë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem doli para njerëzve me qëllim që t'iu tregonte se në cilën natë është nata e Kadrit, mirëpo dy burra prezent filluan të grindeshin mes veti dhe pastaj Allahu hoqi dijen për këtë natë (se në cilën natë është), por la përpjekjen dhe punën në kërkim të saj, në mënyrë që të arrihen vlerat e saj. Një prej urtësive

se pse është fshehur ajo, është që të dallohet njeriu serioz (i përkushtuar) nga dembeli.

### **Cilat janë shenjat e saj?**

Është përmendur në hadithe se në mëngjesin e natës së Kadrit (të nesërmen) dielli lind pa rreze, ndërsa ajo natë është e këndshme, as e ngrohtë shumë e as e ftohtë shumë, gjithashtu besimtari në atë natë ndjen hapje të zemrës e vullnet për të kryer punë të mira.

Janë disa shenja të cilat janë përhapur në mesin e njerëzve kinse janë prej shenjave të natës së Kadrit, si: se në atë natë nuk lehin qentë, se çdo gjë shihet duke i bërë sexhde Allahut, se dëgjoen selamet e engjëjve etj. Këto nuk janë të sakta dhe nuk transmetohen nga Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem.

Ajo që është e rëndësishme, është që muslimani të angazhohet me adhurim ndaj Allahut, ta mbushë këtë natë me adhurime, me namaz nate dhe me lutje drejtuar Atij.

Nga lutjet më të mira që bëhen në këtë natë është ajo e cila transmetohet nga Aisha radijAllahu anha, e cila

e ka pyetur Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem:  
“Nëse e di se cila natë është nata e Kadrit, çfarë të them  
gjatë saj?”, ndërsa ai salAllahu alejhi ue selem i ka  
thënë: “O Allah, Ti fal shumë, e do faljen, andaj më  
fal mua!”

اللَّهُمَّ إِنَّكَ عَفُوفٌ تُحِبُّ الْعَفْوَ فَاعْفُ عَنِّي

"All-llahum-me in-neke afuw-wun tuhib-bul afwe  
féafu an-ní".

## ZEKATI I FITRIT

Nga obligimet e muajit Ramazan dhe me të cilat përmbillet ai në formën më të mirë të mundshme, është edhe zekati i fitrit. Argument për këtë është fjala e Abdullah ibn Umerit radijAllahu anhu i cili ka treguar se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ua kishte bërë obligim muslimanëve dhënien e zekatit të fitrit 1 saa nga hurmat apo nga drithërat, obligim për secilin musliman, qoftë skllav, i lirë, mashkull, femër, i vogël apo i moshuar.

### **Çfarë jepet si zekat i fitrit?**

Duhet të dimë se zekati i fitrit jepet vetëm nga ushqimi. Nuk mjafton të nxirret në të holla, për shkak të fjalës (që sollëm) të ibn Umerit se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e ka bërë obligim dhënien e zekatit të fitrit nga ushqimi. Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve. Kur është pyetur imam Ahmedi rahimehullah për personin i cili e nxjerr zekatin e fitrit në të holla, ka thënë: *“Kam frikë se nuk i mjafton (nuk i pranohet).”*

Personi që e nxjerr atë në të holla, pa dyshim se e kundërshton sunetin e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dhe zbeh të qenët e zekatit të fitrit si rit apo simbol i hapur i muslimanëve, sepse të hollat ekzistonin edhe në kohën e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, megjithatë ai urdhëroi që zekati i fitrit të nxirret në ushqim. Andaj, zekati i fitrit nxirret në ushqim, prej ushqimeve bazike të vendit.

### **Sasia e zekatit të fitrit**

Sasia është 1 saa, që i bie përafërsisht 3 kg.

### **Prej kujt kërkohet zekati i fitrit?**

Ai është obligim të jepet nga i zoti i shtëpisë, i cili e nxjerr atë për veten e tij dhe për anëtarët e familjes. Është e pëlqyeshme të nxirret edhe për fetusin në barkun e nënës. Kështu vepronte Uthmani radijAllahu anhu. Përrjashtohet i varfri i cili nuk posedon ushqimin e asaj dite - ai nuk e ka për obligim ta nxjerrë atë.

## **Koha kur nxirret**

Dijetarët kanë përmendur se janë dy kohë, bazuar në hadithet e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem.

E para: Para Bajramit, një apo dy ditë përpara, kjo është koha kur lejohet të nxirret zekati i fitrit.

E dyta: Pak para namazit të Bajramit, kjo është koha kur është më e vlefshme dhe më mirë të nxirret zekati i fitrit.

## **Kujt i jepet?**

I jepet vetëm një kategorie të njerëzve, e ata janë të varfrit. Përmendet në hadith se *ai është ushqim për të varfrit*. Nuk i jepet tjetër kujt.

## **Dobia e zekatit të fitrit**

Ai e pastron agjëruesin nga gjërat që mund t'i ketë bërë gjatë agjërimit, si: gjëra të ulëta, të kota. Ai korrigjon defektin brenda agjërimit të personit, ashtu siç sehwi sexhdja korrigjon gabimin brenda namazit. Ai e pastron pasurinë e njeriut, bën që t'i hapet zemra dhe të bashkëndjejë me vëllezërit e tij.

## FITORET E SHUMTA NË RAMAZAN

Ramazani nuk është muaj i përtacisë dhe rehatisë. Ai është muaj gjatë të cilit umeti islam përgjatë historisë dha shembuj të mahnitshëm se si duhet të shfrytëzohet ky muaj madhështor. Muslimanët e mëhershëm gjatë Ramazanit bënë luftëra e beteja të ndryshme të cilat tregojnë seriozitetin që kishin dhe të cilat mbrojtën fenë islame, tokën dhe nderin e muslimanëve.

Nuk është e panjohur për të gjithë se si betejat më të njohura në Islam kanë ndodhur pikërisht në Ramazan, siç është beteja e Bedrit, çlirimi i Mekës etj.

Beteja e Bedrit ndodhi në vitin e 2-të hixhri, në Ramazan.

Çlirimi i Mekës ndodhi në vitin e 8-të hixhri, në Ramazan.

Kthimi i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem ndodhi në vitin e 9-të hixhri, në Ramazan.

Beteja el Buwejb ndodhi në vitin e 13-të hixhri (kundër Persëve), në Ramazan.

Çlirimi i Andaluzisë ndodhi në vitin e 91-të hixhri, në Ramazan.

Çlirimi i Amuries ndodhi në vitin e 223-të hixhri, në Ramazan.

(Këto ishin) Beteja të shumta e të llojllojshme, të cilat tregojnë për krenarinë e muslimanëve dhe se ata njerëz e kishin kuptuar ashtu siç duhet muajin e Ramazanit.

Le të ndalemi pak te beteja e Bedrit të cilën Allahu e quajti në Kuran “Jeumel Furkan – Dita e dallimit të vërtetës nga e kota”. Ajo ishte betejë madhështore, mes një ushtrie të fortë, të armatosur e të shumtë në numër (ushtria e jomuslimanëve) dhe një ushtri të paktë në numër dhe me armatim modest (ushtria e muslimanëve). Allahu thotë: **“Allahu ju ndihmoi në Bedër, kur qetë të pafuqishëm, andaj frikësojuni Allahut, për të qenë falënderues”**. Ali Imran 123.

Shkak i kësaj lufte: Ushtria muslimane dëshiroi t'i dilte në pritë një karvani tregtar të fisit Kurejsh, dhe he kështu Allahu bëri bashkë mes muslimanëve dhe jomuslimanëve (në atë situatë) pa u dakorduar

paraprakisht. Muslimanët dolën (në mejdan) të mbështetur në Allahun, ndërsa jomuslimanët dolën me mendjemadhësi dhe sa për sy e faqe të njerëzve, por Allahu i mposhti ata dhe urdhëroi engjëjt të ndihmonin muslimanët duke marrë pjesë në luftë (krahë tyre). Muslimanët dhanë shembuj të mëdhenj të heroizmit, ndërsa paganët (jomuslimanët) u mposhtën dhe u vra koka e tyre Ebu Xhehli, ndërsa kush mundi iku e u largua.

Allahu ka treguar për këtë luftë gjersa Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ishte në Meke, **“Grupi i tyre (mekasve) është vetëm një prej ushtrive, të cilat do të shpartallohen.”** Sad 11. Ishte prej shenjave të Profetësisë që tregonte se paganët do të mposhteshin nga Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem. Pastaj, muslimanët u kthyen në Medine me ndihmën e Allahut si fitimtarë dhe përgëzimet për fitoren arrtën në Medine, ndërsa paganët u kapluan nga zhgënjimi e pikëllimi i madh për shkak të disfatës dhe mposhtjes. Kështu, fiset që banonin përreth Medinës filluan t’i frikësoheshin Pejgamberit salAllahu alejhi

ue selem dhe muslimanëve dhe filluan të kuptonin se muslimanët ishin bërë tashmë fuqi.

# RAMAZANI – MUAJI I NDRYSHIMEVE

## RAMAZANI - MUAJI I NDRYSHIMIT

Të gjithë njerëzit e mençur në mesin e muslimanëve janë të pajtimit se Ramazani është një muaj i ndryshimit, reformimit dhe ripërtëritjes shpirtërore. Ai i ndryshon dhe i gdhend shpirtrat e njerëzve, i ripërtëritë vendosmëritë dhe ambiciet e tyre, bën ndryshim jetësor dhe qenësor në jetën e besimtarit, gjë që nuk e ka provuar (përjetuar) më herët, sepse Ramazani ndryshon rutinën ditore të njeriut e ia pastron shpirtin, dhe kështu lëvizjet e tij ndryshojnë, gjymtyrët e tij qetësohen, veprat e mira të tij shtohen dhe pastaj nxiton drejt veprave të mira që i japin lumturi.

Ky kuptim është zhvendosur edhe te masa e gjerë e muslimanëve (e kuptojnë) dhe kanë filluar të ndjejnë se është e domosdoshme të ndryshojnë dhe të reformohen shpirtërisht gjatë Ramazanit. Thonë: “Nëse nuk ndryshoj tani në Ramazan, kur do të ndryshoj?” Allahu thotë: **“Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç’kanë në vetvete.”** Rad 11.

Ramazani (tek ata që ndryshojnë gjatë tij) nuk është vetëm për të shtuar veprat e mira dhe për t'u larguar nga mëkatet. Ata e shohin atë si një rast të volitshëm për ndryshim të vetvetes, për korrigjim nga gabimet, për korrigjim të gjymëtarëve, të veprave dhe të defekteve brenda veprave të tyre, në mënyrë që pastaj të shijojnë siç duhet këtë kuptim madhështor (ndryshimin e reformimin gjatë Ramazanit) dhe që Ramazani të jetë sezon i ambicieve të larta, i mirëqenies e i ngritjes shpirtërore, nga i cili dalin me një anë shpirtërore të lartë, e cila pastaj ia trason një metodologji madhështore se si duhet të ecin në jetën e tyre, përmes së cilës do të ruajnë veten dhe veprat dhe do të bëhen të qëndrueshëm në rrugën e Allahut. Ata e shfrytëzojnë Ramazanin si një portë madhështore për pendim.

Megjithëkëtë që u tha, personi duhet të ketë një iniciativë të brendshme, një vendosmëri, dhe duhet të zhveshë veten nga çdo gjë që e dëmton agjërimin, si: nga defektet, ego, dëshirat, tekjet etj. Kjo në mënyrë që ndryshimi të jetë i vërtetë dhe i vlefshëm dhe po ashtu që të realizojë ajetin: “**Allahu nuk e ndryshon**

**gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç'kanë në vetvete". Rad 11.**

Shumë njerëz ndryshojnë gjatë Ramazanit dhe përmirësohen, porse këtë ndryshim nuk e ruajnë pas Ramazanit. Kjo është një gjë shumë e rrezikshme. Duhet të ndryshojmë gjatë Ramazanit dhe pastaj ta ruajmë këtë ndryshim, këtë dobi të madhe të përfituar.

Disa mënyra me anë të të cilave ruhet ky ndryshim, p.sh.: ripërtëritja e nijetit të sinqertë, luftimi i vetes, ndryshimi i shprehive të këqija, lutja tek Allahu për qëndrueshmëri në fe etj.

Të gjitha këto na shpërfaqin se sa madhështore është kjo begati e Allahut: Muaji Ramazan, të cilin Ai na ka dhuruar.

Ramazani me të vërtetë është një shkollë shpirtërore, një institut i ndërtimit dhe ndryshimit të shoqërisë. Qysh në fillim të Ramazanit në shpirtrat e njerëzve buron një kënaqësi e lumturi shumë e madhe. Allahu hedh në zemrat e tyre dashuri e respektim për këtë muaj, nxitim në vepra të mira, largim nga mëkatet,

madje vërejmë se edhe mëkatarët e mëdhenj fshehin disa prej mëkateve të tyre që kanë bërë. Ky është Ramazani. Këto janë mrekullitë dhe sekretet e tij.

## **RAMAZANI NDRYSHON TRUPIN E NJERIUT**

Agjërimi në përgjithësi, e në veçanti gjatë Ramazanit, ndryshon/përmirëson trupin e njeriut. Kjo pa dyshim nga aspekti se njeriu e ka për obligim të përmbahet nga ushqimi e pirja dhe nga gjërat që ia prishin agjërimin. Kështu muslimani agjëron përafërsisht 12 orë apo më shumë, gjatë të cilave nuk shijon as ushqim e as pije, dhe këtë e bën duke kërkuar shpërblimin e Allahut, siç thotë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem: **“Kush agjëron me besim tek Allahu dhe duke llogaritur shpërblim tek Ai...”**

Nëse njeriu është i atillë që ha e pi shumë, atëherë duke agjëruar, gdhend/edukon veten e tij, ndërsa duke përmendur Allahun gdhend anën shpirtërore, dhe kështu prej trupit të tij largohen sëmundje të ndryshme e pastaj ndjen rehati e qetësi shpirtërore dhe shëndet të plotë. Ashtu siç agjërimi është një ilaç

që sjell lumturi, po ashtu është një ilaç që jep fuqi fizike dhe të mëson se si të përballesh me gjëra që të rrethojnë dhe se si të jesh i durueshëm. Transmetohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Agjëroni që të jeni të shëndetshëm!”** Zinxhiri i hadithit është i dobët, mirëpo mund të themi se kuptimi nga aspekti që cekëm, është i saktë. Pra, agjërimi trajton dhe shëron sëmundje të ndryshme.

Në anën tjetër, vërejmë se gjatë Ramazanit edhe konsumimi i ushqimeve pakësohet. Agjëruesi çel iftarin me hurma e ujë, pastaj ha një lloj a dy lloje të ushqimeve dhe ndjen se është ngopur. Madje, edhe pesha e disa njerëzve ndryshon për shkak të agjërimit dhe të ndryshimit të mënyrës së të ushqyerit. Të gjithë e kuptojnë se agjëruesi largon urinë e tij me një shujtë të lehtë në iftar (pa tryezë të gjerë e të mbushur).

Edhe trupat e atyre që pinë duhan (e ky është mëkat) bëhen më të shëndetshëm në Ramazan dhe shpirtrat i kanë me të qetë, pastaj pas Ramazanit shfrytëzojnë këtë gjë për braktisjen e duhanit apo pakësimin e tij.

Agjëruesi pëson ndryshim edhe në aromën e gojës së tij. Megjithatë, kjo aromë është e atillë siç tregon Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem: **“Aroma e keqe në gojën e agjëruesit është më e dashur tek Allahu se aroma e parfumit.”**

Agjëruesi i gëzohet iftarit, **“Agjëruesi ka dy gëzime: njëri kur çel iftarin dhe tjetri kur takon Zotin e tij (dhe i gëzohet shpërblimit të madh për agjërimin)”**. Kur dëgjon këto hadithe madhështore, atëherë gjallërohet shpirti e trupi, shtohet dashuria për agjërimin dhe kupton se kjo botë me kënaqësitë e saj nuk mund të krahasohet aspak me një çast agjërimi që bëhet për hir të Allahut në muajin e Ramazanit.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem duke treguar pozitën e lartë të agjërimit, i thotë një prej shokëve të tij: **“Përmbaju agjërimit, sepse nuk diçka të ngjashëm si ai.”** Shpërblimi për agjërimin është madhështor, pozita e tij është shumë e lartë dhe dobitë e tij janë të shumta e të llojllojshme saqë nuk mund të kufizohen në numër.

## RAMAZANI NDRYSHON MËNYRËN E TË MENDUARIT

Ramazani ndryshon dhe mënyrën e të menduarit të njeriu. Është e mundshme që njeriu të ndryshojë pikëpamjet e botëkuptimet e tij gjatë Ramazanit duke u bërë më të mira. Nga to:

~Pikëpamjet lidhur me jetën e kësaj bote dhe kënaqësitë e saj. Gjatë Ramazanit agjërimi ia kujton njeriut vazhdimisht Allahun, nënshtrimin ndaj Tij, e nxit drejt botës tjetër e cila është më e mirë sesa kjo botë, e nxit të përgatitet për botën tjetër, e pa dyshim se agjërimi është prej portave më të rëndësishme drejt kësaj. Për agjëruesin do të jetë xheneti dhe porta Er Rajjan. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Askush përveç agjëruesve nuk mund të hyjë në të. Dhe kur të futen në të agjëruesit, deri tek i fundit, ajo mbyllet.”**

~Pikëpamjet lidhur me asketizmin - palakmia ndaj jetës së kësaj bote. Agjërimi bën që njeriu të mos mbajë lidhje të panevojshme me njerëzit, të mos e teprojë në lidhjet me ta, ai e gdhend trupin e tij dhe

anën morale e shpirtërore dhe bën që të bëjë një jetë modeste.

~Pikëpamjet lidhur me pozitën e adhurimeve. Personi që agjëron për hir të Allahut arrin lumturinë e vërtetë, realizon pastërtinë shpirtërore, i rritet dashuria për adhurime dhe kupton se tek agjërimi gjenden mirësitë e të dy botëve. Kjo shfaqet qartë tek ata persona të cilët para Ramazanit janë të shkujdesur ndaj kryerjes së adhurimeve dhe janë të privuar nga kënaqësia e bindjes ndaj Allahut.

~Pikëpamjet lidhur me mendimet. Njeriu zgjohet nga shkujdesja e humbja dhe fillon të mendojë se çfarë e pret në të ardhmen, kah është duke shkuar dhe se pse ekziston në jetën e kësaj bote. Allahu thotë: **“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?”** Kijjame 36. Andaj dhe shohim se shumë njerëz udhëzohen gjatë Ramazanit dhe kthehen tek Allahu sinqerisht, ngase ka ndryshuar mënyra e të menduarit dhe botëkuptimeve të tyre. Mendjet e tyre janë bërë të shëndetshme, rruga e tyre në ecjen e kësaj bote ka ndryshuar rrënjësisht. Ramazani ngjall

shpirtin dhe bën që njeriu të mendojë rreth realitetit të tij dhe asaj çfarë kërkohet prej tij.

~ Pikëpamjet lidhur me leximin e Kuranit me meditim. Kurani dhe leximi i tij, ndryshojnë te njeriu kuptimet që ka dhe ia korrigjojnë ato. Kurani i jep besim të saktë dhe i jep kuptim të thellë rreth Allahut, vetvetes, veprave, sjelljeve dhe jetës së tij. Mirëpo, këtë e arrijnë vetëm ata që meditojnë rreth Kuranit. Allahu thotë: **“A nuk përsiatin ata për Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.”** Nisa 82. Dhe: **“Vallë, a nuk përsiatin ata për Kuranin apo i kanë zemrat të kyçura?!”**

~ Pikëpamjet lidhur me urinë e etjen. Ato ia kujtojnë urinë e etjen e Ditës së Gjykimit. Andaj, si rezultat besimtari vazhdimisht kujton botën tjetër (se çfarë e pret). Allahu i qorton në Kuran disa njerëz të cilët kanë harruar kujtimin e botës tjetër, **“ata e duan më shumë jetën e kësaj bote, sesa jetën e botës tjetër”**. Nahl 107. Dhe i ka lavdëruar ata që vazhdimisht mendojnë për botën tjetër: **“Ne u dhuruam atyre një**

virtyt të veçantë, që ta kenë gjithmonë në mend botën e ardhshme". Sad 46.

### **RAMAZANI NDRYSHON VEPRAT E NJERIUT**

Ramazani ndryshon veprimet e punët e njeriut dhe këtë e vërejmë shumë qartë. Kështu, para Ramazanit tregohet dembel në kryerjen e punëve të mira, madje ndodh të bëjë gjynahe të shumta, mirëpo sa të hyjë Ramazani shpirti i tij ndryshon, ndërgjegjja e tij aktivizohet e gjallërohet dhe ai ndjen se patjetër duhet të ndryshojë e të ripërtërijë besimin, veprat dhe ambiciet e tij. Ai e kupton se nga shkujdesja dhe gjynahet e kryera më herët duhet të marrë mësim dhe se duhet të kthehet me pendim tek Allahu, duke iu bashkëngjitur karvanit të njerëzve të mirë, të cilët pendohen.

Vërejmë se gjatë Ramazanit, ai që ka bërë keq pendohet, ai që është treguar dembel gjallërohet, ai që është treguar i shkujdesur korrigjohet e përmirësohet dhe mëkatari pendohet.

Edhe programi ditor i përditshëm ndryshon gjatë Ramazanit, kjo për shkak të natyrës së agjërimit dhe ndjesisë së etjes, urisë e lodhjes.

Ai që deri dje ka shkuar në vende të kota ku kryhen gjynahe, e ndryshon këtë dhe bën që hapat e tij të ecin drejt xhamive për namaz të teravive, ku me një hap që bën e ngrit Allahu një gradë dhe me hapin tjetër që bën, ia fshin një gjynah. Ai që deri dje nuk ka ditur se çfarë është namazi i natës, fillon të falet gjatë Ramazanit dhe ndjen ëmbëlsinë e tij. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kush falet me imamin derisa të përfundojë namazin (teravitë), i shkruhet sikur të jetë falur tërë natën.”** Dhe: **“Kush falet gjatë Ramazanit me besim dhe me shpresë (në shpërblim) i falen gjynahet e kaluara.”**

Ramazani është ndryshim rrënjësor e qenësor, si në aspektin fizik ashtu dhe në atë shpirtëror. Ai ndryshon jetën e njeriut. Njeri i mençur është ai i cili bashkëvepron ashtu siç duhet me të.

Ramazani ndryshon veprimet e veprat e njeriut, megjithatë ai duhet të ndër marrë iniciativë nga ana e

tij, duhet të ndjejë siç duhet përgjegjësinë që ka. Ramazani nuk të ndryshon nëse ti nuk e do ndryshimin, nëse nuk e kap musafin e nëse nuk e përmend Allahun.

Është e vërtetë që kur sheh njerëzit përreth duke bërë vepra të mira, do të nxitesh edhe ti drejt tyre, megjithatë duhet të dish se ata nuk i kryejnë punët në vendin tënd sepse Allahu të ka dhënë duar, këmbë, zemër e mendje, andaj duhet të shfrytëzosh këtë shans madhështor, duhet të lëvizësh gjymtyrët e tua, duhet të braktisësh përtacinë e të shikosh përpara. Askush në vendin tënd nuk lexon Kuran e nuk e përmend Allahun.

Andaj, si përfundim, duhet patjetër të nxitosh drejt punëve të mira dhe të bësh gara me të tjerët drejt tyre.

## **RAMAZANI NDRYSHON NIJETIN E NJERIUT**

Personi i cili është sprovuar me njolla e defekte në nijetin dhe sinqeritetin e tij, atëherë pa dyshim se Ramazani është ilaç për këtë, ai që fshin dhe largon defektet që janë brenda e të ngulitura thellë në

zemrën e njeriut. Allahu thotë: **“që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë”**. Bejjine 5.

Ramazani me të gjitha veçoritë dhe karakteristikat që ka, është shkak nga shkaqet më madhështore për pastrimin dhe korrigjimin e njetit. Allahu e ka bërë të tillë. Kjo nga disa aspekte:

- Agjërimi në vetvete është edukim për të arritur sinqeritetin, sepse është sekret mes njeriut dhe Zotit të tij. Gjurmët e agjëritit nuk shfaqen qartë para njerëzve të tjerë. Njeriu ka mundësi të futet në shtëpinë e tij të hajë sa të dojë, pastaj të dalë para njerëzve duke pretenduar se kinse është agjërueshëm. Dhe sipas këtij kuptim është sqaruar hadithi i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem i cili ka thënë: **“Allahu thotë: “Çdo vepër e birit të Ademit është për të, përveç agjëritit, ai më përket Mua dhe Unë shpërblej për të.”** Agjërimi të jep sinqeritet madhështor karshi raportit me Allahun.

- Agjërimi të mundëson të arrish devotshmërinë, dhe kjo është nga urtësitë më të mëdha se pse Allahu e ligjësoi agjërimin. Mirëpo, ajo nuk mund të arrihet

përveçse kur agjëron ashtu siç kërkon Allahu, siç ka thënë: **“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të bëheni të devotshëm.”** Bekare 185.

● Numri i madh i punëve që kryen në Ramazan dhe llojllojshmëria e tyre, prekin zemrën e shëndoshë të besimtarit. Kjo bën që ai të korrigjojë mënyrën e jetesës dhe t’i shërohen prishjet brenda zemrës dhe ndërgjegjes së tij. Duhet të dimë se nuk mund të kënaqesh me Ramazanin, përveç nëse je i sinqertë dhe i vërtetë me Allahun, i cili ka thënë: **“...do të ishte më mirë për ata që të tregohen të sinqertë ndaj Allahut.”** Muhamed 21. Mirësia, ëmbëlsia e kënaqësia e plotë vjen vetëm kur ti tregohesh i sinqertë me Allahun. Sinqeriteti është bërthama e lumturisë, rehatisë dhe jetës së mirë shpirtërore. Allahu thotë: **“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.”** Nahl 97. Patjetër duhet t’i pastrojmë njetet tona, të largojmë nga zemra syfaqësinë e dëshirën për famë,

duhet t'i bëjmë veprat tona vetëm për hir të Allahut dhe duhet të trajtojmë ngurtësinë e vrazhdësinë e zemrave tona. Dijetari i madh islam ibn Tejmije rahimehullah, njeriu me dije e me vepra madhështore, (e megjithëkëtë) ka thënë: *“Pasha Allahun, unë deri më tani e ripërtërij Islamin tim, gjatë tërë kohës, dhe deri më tani nuk jam futur në Islam ashtu siç kërkohet.”*

### **RAMAZANI NDRYSHON MORALIN E NJERIUT**

Ramazani ndryshon moralin, sjelljen dhe edukatën e njeriut. Morali është ajo që ai shfaq para të tjerëve dhe në bazë të tij pastaj të tjerët gjykojnë për të (se a është i mirë apo i ulët e i pasjellshëm). Kur njeriu ka moral të mirë, ngrehët dhe lartësohet, si tek Allahu po ashtu dhe te njerëzit, në të kundërt do të ulet ai dhe pozita e tij (në varësi të moralit të keq që ka). Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Njeriu me moralin e tij të mirë arrin gradën e atij personi i cili agjëron dhe falet vazhdimisht gjatë natës (nafile).”**

Se çfarë është morali i mirë, brezat e parë të Islamit e kanë përmbledhur me pak fjalë, si: takimi i njerëzve me fytyrë të qeshur e të hapur, ndihma ndaj tyre dhe moslëndimi i tyre.

Besimtari, për të gjitha këto kuptime, ka nevojë në Ramazan. Në këtë muaj zemra e tij hapet dhe ndjen autoritetin e këtij muaji dhe mirësinë e tij. Andaj, është e domosdoshme që të përmirësojë shpirtin, të gdhendë sjelljet e moralin dhe të ruajë gjuhën. Ramazani ndalon nga polemikat, nga debatet dhe nga armiqësitë e ndryshme. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Nëse dikush ofendon agjëruesin apo e armiqëson atë, le t’i thotë: “Unë jam agjërueshëm!”** Këtë shprehje na ka mësuar Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem në mënyrë që të tërhiqemi, të ruajmë gjuhën dhe të largohemi nga gjë që shkakton polemika e armiqësi. Dhe ka thënë: *“Kush nuk braktis gënjeshtren dhe të vepruarit me të si dhe injorancën, le të dijë se Allahu nuk ka nevojë që ai të braktisë ushqimin dhe pijen e tij.”*

Agjërimi frenon shpirtin dhe mban nën kontroll sjelljen e njeriut. Nuk është në rregull që së bashku

me agjërimin të merret me gjëra të kota, t'i shpeshtojë fjalët dhe të veprojë të këqija. Për këtë arsye, kjo gjendje shpirtërore gjatë Ramazanit, e thërret muslimanin të përmirësojë moralin e të gdhendë sjelljet e tij. Kështu, ai do të tërhiqet nga gënjeshtria, nga të metat e gjuhës, do ta ruajë atë, do të angazhohet me përmendjen e Allahut dhe me fjalë të dobishme. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit, le të flasë mirë ose le të heshtë!”**

Gjithashtu vërejmë se gjatë Ramazanit edhe personi i vrazhdë i cili flet fjalë të rënda, qetësohet, përulet, angazhohet me dhikër, me lexim të Kuranit etj.

Nga e gjithë kjo mësojmë se sezoni i Ramazanit është një rast i artë e i volitshëm për ndryshimin e sjelljeve tona, për ripërtëritjen e tyre, kjo për shkak të disa gjërave, si:

- Muslimani është urdhëruar të ketë moral të mirë gjithmonë, mirëpo në Ramazan edhe më shumë.
- Atmosfera e Ramazanit është e atillë e cila njeriut ia imponon qetësinë e butësinë dhe pakësimin e

zemërimit e hidhërimit. Ai që sillet keq gjatë Ramazanit, është ai i cili nuk ia di vlerën atij dhe nuk e shijon siç duhet.

- Edhe nëse njeriu në fillim tregohet i papërmbajtur, flet fjalë të këqija, ngreh zërin, zemërohet shpejt, ai korrigjohet dhe kthehet pastaj, duke sjell ndërmend pozitën e lartë që ka Ramazani dhe se patjetër duhet të bëjë durim e të ruajë gjymtyrët e veprimet e tij.

- Ramazani me të gjitha mirësitë që përmban e edukon shpirtin me durim. Ai është muaji i durimit, muaji i përmbajtjes. Allahu thotë: **“Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë”**. Zumer 10. E në mesin e të durueshmëve hyjnë dhe agjëruesit, siç thonë dijetarët. Nga durimi buron çdo moral i mirë dhe i lartë.

## **RAMAZANI NDRYSHON TË FOLURIN TONË**

Ramazani ashtu siç ndryshon moralin tonë në përgjithësi, ndryshon edhe mënyrën se si flasim dhe u drejtohem tjerëve. Rreziku i gjuhës dhe defektet e saj janë tepër të mëdha. Gjuha mund të shkaktojë

dëme të konsiderueshme e të pariparueshme. Për këtë arsye, kur Muadhi ibn Xhebeli radijAllahu anhu e pyeti Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem se a do të merremi në llogari edhe për fjalët që flasim, i tha: *“Të pastë nëna o Muadh! A i hedh njerëzit me fytyra në Zjarr diçka tjetër përveçse pasojat e gjuhëve të tyre?!”*

Pasojat e gjuhës dhe defektet e saj janë të shumta. Ndodh që njeriu të flasë një fjalë e cila i duket e lehtë, mirëpo ajo ia prish gjuhën, ia errëson zemrën dhe bën që ai të rrëshqasë në Zjarrin e Xhehenemit 70 vite apo në një hapësirë që është më e largët sesa hapësira mes lindjes dhe perëndimit (siç transmetohen hadithet e sakta). Për këtë, ne duhet të ndryshojmë të folurit gjatë Ramazanit, përndryshe nuk kemi përfituar nga agjërimi ynë.

Personi që e ka shprehi të gënjejë, duhet ta ketë frikë Allahun dhe të përmbahet nga gënjeshtria. Personi që bart fjalë mes njerëzve duhet të braktisë këtë moral të ulët. Personi që përgojon të tjerët duhet të kontrollojë dhe korrigjojë vetveten. Personi që e ka gjuhën e gjatë, duhet të pakësojë fjalët. Këta njerëz, duhet të

sjellin ndërmend se do të merren në llogari para Allahut për çdo fjalë që flasin. Allahu thotë: “...**dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).**” Surja Kaf 18.

Shkaqet që ndihmojnë në ruajtjen e gjuhës (gjatë Ramazanit dhe gjatë jetës):

◇ Të agjërosh me agjërim të vërtetë, të sinqertë, për hir të Allahut, duke plotësuar kushtet dhe edukatën e agjërimit.

◇ Ta angazhosh gjuhën me përmendjen e Allahut, me leximin e Kuranit, me fjalët: SubhanAllah, elhamdulillah, La ilahe ilAllah, Allahu ekber.

◇ Të qëndrosh/izolohesh në xhami për një kohë më të gjatë që të pakësosh përzierjen me njerëzit.

◇ Të largohesh nga ndejat e kota e të angazhohesh me çështje serioze (të mira), si: leximi i një libri të dobishëm, shoqërimi me njerëz të mirë, pjesëmarrja në projekte bamirësie e ndihme etj.

◇Të luftosh vetveten, sepse ndryshimi prej një gjendje të tillë në një gjendje tjetër, është i vështirë dhe ka nevojë për durim e luftim të vetvetes. Ramazani përmban të gjithë faktorët që ndihmojnë njeriun të arrijë këtë ndryshim e transformim të vetes.

◇Të sjellësh ndërmend vazhdimisht se çfarë pasoja ka nëse e lë gjuhën të lirë, dhe një nga to është se Allahu nuk ia pranon agjërimin, siç transmetohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kush nuk braktis gënjeshtren, të punuarit me të dhe injorancën, le të dijë se Allahu nuk ka nevojë që ai të braktisë ushqimin dhe pijen e tij.”** Buhariu.

## **RAMAZANI NDRYSHON VENDOSMËRITË DHE AMBICIET E NJERIUT**

Vërejmë se disa njerëz, para se të hyjë Ramazani, kanë ambicie e vendosmëri të dobëta. Vijnë në namaz me përtaci, falen me përtaci, Kuranin ndoshta e braktisin, nuk e lexojnë gjatë vitit, veprat vullnetare i kanë të pakta, janë të zhytur në jetën e kësaj bote dhe vrapojnë pas saj. Megjithatë, posa të hyjë Ramazani,

ndryshon shoqëria, kështu njerëzit fillojnë urimet ndaj njëri-tjetrit, ndryshon atmosfera, dhe kjo e nxit personin që të fillojë të ndryshojë dhe të ripërtërijë lidhjen e tij me Allahun. Kjo bën që atij t'i ndezët ambicia dhe vendosmëria, të ndjejë Ramazanin, e më e rëndësishmja të lakmojë që edhe ai t'i bashkëngjitet të tjerëve dhe të fillojë të përmirësojë veten. Çdo gjë ndryshon gjatë Ramazanit, madje edhe ambicia e vendosmëria e njeriut. Ramazani mund ta ndryshojë dhe trajtojë edhe një gjë të tillë.

Vërejmë se shumë njerëz nuk e dinë se çfarë është të përfundosh leximin e Kuranit, mirëpo gjatë Ramazanit e përfundojnë atë.

Disa të tjerë nuk e dinë se çfarë është të falësh namaz gjatë natës, mirëpo gjatë Ramazanit janë të rregullt në namazin e teravive. Allahu, duke nxitur që njerëzit të falen gjatë natës, thotë: **“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë”**. Sexhde 16. Vërejmë se ata qajnë së bashku me të tjerët dhe përulen gjatë leximit të Kuranit. Ata japin lëmoshë edhe pse para Ramazanit ishin koprracë dhe lakmitarë.

Përmbledhtas themi se Ramazani është një shans madhështor që ne të ndryshojmë. Madje, ai ndryshon edhe një nga elementet kyçe dhe themelore të njeriut, që është ambicia dhe vendosmëria, të cilat burojnë nga një zemër e mbushur me besim dhe mirësi.

Nuk është e tepërt të themi se Ramazani është muaj i ambicieve dhe i vendosmërive të larta, muaj i cili largon nga njeriu dembelinë, muaj i cili e nxit të nxitojë drejt Zotit të tij me vendosmëri dhe sinqeritet. Për këtë arsye, vërejmë se brezat e parë të Islamit, Ramazanin e kuptonin si muaj të sakrificës së madhe.

Në kohën e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dy luftërat kryesore janë zhvilluar pikërisht në Ramazan, që është beteja e Bedrit dhe Çlirimi i Mekës. Allahu thotë: **“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit”**. Ali Imran 133, dhe: **“Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe Na luteshin, me shpresë e frikë dhe ishin të përlurur ndaj Nesh”**. Enbija 90.

## RAMAZANI NDRYSHON MËNYRËN E GARIMIT NË PUNË TË MIRA

Ramazani na mëson se si duhet të jetë garimi i vërtetë dhe tregtia e vërtetë me Allahun. Allahu duke përmendur xhenetin dhe shpërblimin në të thotë: **“Për këtë, le të përpiqen ata që përpiqen.”** Mutaffifin 26.

Para Ramazanit njerëzit garojnë për të mbledhur pasuri të kësaj bote, e posa të hyjë ai, agjëruesi arrin të kuptojë qartë se tregtia duhet të jetë vetëm me Allahun. Ai ndryshon trupin e tij i cili deri dje vraponte pas grumbullimit të pasurisë, ndërsa tani ai i nënshtrohet Allahut, ajeteve, tregohet modest ndaj të varfërve, i dhembshur ndaj të dobëtëve, u bën mirë njerëzve, shpenzon, jep djathtas e majtas, duke pasur frikë Allahun qoftë dhe me gjysmë hurme, siç thoshte Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem.

Ibn Abbasi radijAllahu anhu na pasqyron këtë gjë shumë qartë dhe e ndërlidh me Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem duke thënë: *“I Dërguari salAllahu alejhi ue selem ishte njeriu më bujar e më dorëlibër, dhe kjo i shfaqej më së shumti gjatë Ramazanit.”*

Kuptimi i bujarisë pa dyshim se rritet gjatë Ramazanit, mirëpo vetëm tek ata persona të cilët e dinë vlerën dhe mirësinë e tij. Andaj, garimi i njerëzve në Ramazan bëhet se kush po jep më shumë, kush po tregohet më dorëlibër, kush po e adhuron Allahun më shumë, kush po e lut e po e përmend më shumë, kush po lexon Kuran më shumë, kush po i mëson të tjerët më shumë, kush po ndihmon më shumë etj.

Ibn Rexhebi rahimehullah ka thënë: *“Bujaria e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem gjatë Ramazanit i përfshinte të gjitha këto kuptime.”* Ai përmend se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem tregojte bujar me dijen e tij (duke e shpërndarë), me pasurinë e tij, me veten e tij, u bënte dobi të tjerëve me çdo metodë dhe rrugë të mundshme, ushqente të varfrit e të uriturit, këshillonte ata që nuk kishin dije të bollshme fetare dhe injorantët, ua përmbushte kërkesat e nevojat nevojtarëve e të tilla. Këto ai i bënte edhe para se të bëhej Pejgamber. Megjithatë, kur i erdhi Shpallja, atëherë këto mirësi (ndaj të tjerëve), iu shtuan edhe më shumë. Enesi radijAllahu anhu ka

thënë: *“Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ishte njeriu më i mirë, më trimi, më bujari.”*

Gjithashtu transmetohet te Buhariu se Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem nuk i është kërkuar diçka për hir të Islamit veçse e ka dhënë atë. Një ditë ka ardhur një njeri tek ai dhe i ka kërkuar dhe ai i ka dhënë një tufë të madhe me bagëti, që ishte në një luginë mes dy kodrinave. Pastaj ai njeri u kthye te populli i tij e iu tha atyre: *“Bëhuni muslimanë, sepse Muhamedi salAllahu alejhi ue selem jep aq shumë sikur të ishte njeri që nuk frikësohet fare nga varfëria.”*

Edhe muslimani i cili është i ndërgjegjshëm dhe e kupton siç duhet vlerën dhe mirësinë e Ramazanit, mund të praktikojë të gjitha këto apo një pjesë të tyre. Dhe në këtë mënyrë, ndryshon mënyrën se si ka garuar me të tjerët më parë.

Nga ana tjetër, personit të zhytur në epshe e në vrapimin pas tyre dhe gjërave të ulëta të kësaj bote, nëse Allahu ia mundëson të arrijë Ramazanin, shohim se si ai e shfaq haptazi pendimin dhe kthimin e tij tek Allahu, se si e mposht shejtanin dhe e lufton

vetveten, në mënyrë që të arrijë lumturinë e vërtetë dhe që të përjetojë edhe ai gëzimin që jep besimi.

Vrapimin pas epsheve, njerëzit e bëjnë që të arrijnë një kënaqësi e përkohshme e jetës së kësaj bote, mirëpo kënaqësia që arrihet përmes Ramazanit, që është kënaqësi e përhershme, përderisa nuk e cenon apo e prish atë, nuk ka mundësi të krahasohet me epshet e shkurta të kësaj bote, të cilat lënë pas pasoja, lodhje dhe sëmundje të trupit e të zemrës.

Veprat e atyre njerëzve seriozë dhe të cilët punojnë, pa dyshim se gjatë Ramazanit shpeshtohen. Ata shpeshtojnë veprat të cilat afrojnë tek Allahu, ata përfundojnë hatme pas hatmeje, ashtu siç vepronin edhe brezat e parë të Islamit. Nuk ka gjë më të këndshme për agjëruesin sesa përmendja e Allahut dhe leximi i Kuranit.

Përmbledhtas, garimi në punë të mira në Ramazan, përfshin shumë gjëra, nga to është edhe rregullimi e hijeshimi i agjërimit, angazhimi sa më shumë me leximin e Kuranit, me përmendjen e Allahut, me shërbimin ndaj njerëzve, me shtrimin e iftareve, me

ndihmën ndaj nevojtarëve, me faljen e namazit gjatë natës, me mësimin e atyre që nuk kanë dije, me ruajtjen e gjymtyrëve nga ndalesat e mëkatet, me ruajtjen e gjuhës, me nxitimin drejt punëve të mira, me shpeshimin e lutjeve tek Allahu dhe të tilla.

### **RAMAZANI NDRYSHON FËMIJËT TANË**

Edhe fëmijët, si çdo person tjetër, ndjejnë një gëzim të madh kur arrin Ramazani, ata vërejnë se si ndryshojnë gjërat përreth tyre. Andaj, prindi i mençur duhet ta shfrytëzojë këtë gjë dhe të ndikojë tek ta përmes xhamisë dhe shtëpisë ku jetojnë. Kështu, i nxit që të agjërojnë, të respektojnë Ramazanin e Kuranin, ta lexojnë atë, ta përmendin e ta duan Allahun, të tregohen bujar, të japin lëmoshë sado pak, siç thoshte Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem: **“Ki frikë Allahun, qoftë dhe duke dhënë lëmoshë gjysmë hurme!”** Dhe kur përmendte lëmoshën thoshte: **“...edhe nëse e takon vëllain tënd musliman me fytyrë të buzëqeshur.”** Dhe: **“Edhe fjala e mirë është lëmoshë.”**

Pa dyshim se Ramazani është mjet edukativ shumë madhështor, i cili rrënjos te fëmijët këto kuptime madhështore, që kanë të bëjnë me bindjen ndaj Allahut dhe nënshtrimin ndaj Tij.

Prindi, duhet të ndër marrë disa hapa. Nga to janë:

- Të mësojë fëmijët qysh në vegjëli që të agjërojnë, aq sa (fëmijët) kanë mundësi.
- T'ua bëjë shprehi leximin e Kuranit dhe librave të dobishëm.
- T'iu japë dhurata e shpërblime për inkurajim drejt këtyre veprave.
- Të bëjë ndeja të shkurta me anëtarët e shtëpisë gjatë të cilave u flet për vlerën që ka Ramazani dhe nxitimi drejt punëve të mira.
- T'i marrë me vete në xhami për namazin e teravive dhe për namazet ditore.
- T'i marrë me vete edhe në takimet shoqërore ku përmendet Allahu dhe punët e mira.
- T'ua mësojë edukatën e Ramazanit, moralin e agjëruësve dhe se besimtari nuk duhet t'i bëjë të njëjta

ditët e agjërimit sikur ditët e tjera të zakonshme të vitit, përkundrazi, duhet të mësohen të edukohen me edukatën e agjërimit e të ruajnë gjuhën dhe gjymtyrët, që agjërimi i tyre të jetë i plotë.

○ T'i bëjë pjesëmarrës në projektet e bamirësisë, siç është shtrimi i iftareve, ndihma ndaj nevojtarëve etj.

### **RAMAZANI NDRYSHON XHAMITË TONA**

Atmosfera në xhamitë tona gjatë Ramazanit ndryshon shumë. Ato mbushen me namazfalës, me lexues të Kuranit e me përmendës të Allahut, sepse siç ka thënë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem: **“Ajo është shtëpia e besimtarit”**, apo: **“Ajo është shtëpia e çdo të devotshmi.”** Xhamia është sikur shtëpia e njeriut nga e cila nuk ka mundësi të pavarësohet.

Pa dyshim se kur njeriu është në xhami, ndjen skajin e pastërtisë shpirtërore dhe të lumturisë së brendshme.

Xhamia pranon ndryshim gjatë Ramazanit, qoftë në aspektin konkret apo kuptimor.

Në aspektin konkret: Njerëzit i kushtojnë rëndësi të madhe xhamisë, në pastërti, në zbukurim, në rregullim të saj etj.

Në aspektin kuptimor: Shpirtrat e njerëzve anojnë më shumë drejt xhamive, ato mbushen me njerëz që nuk e kishin të zakonshme të futen në xhami para Ramazanit, mbushen me ata që qëndrojnë në të për të lexuar Kuran dhe e përjetojnë dhe shijojnë një gjë të tillë. Leximi i Kuranit në shtëpi nuk mund të krahasohet me leximin e Kuranit në xhami.

Sa më shumë që njerëzit të tubohen në xhami, kjo bën që të tjerët të ndikohen më shumë për t'u aktivizuar dhe gjallëruar drejt adhurimeve të ndryshme.

Allahu thotë: **“Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zeqatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut”** Teube 18. Ky është ajet madhështor e dëshmi hyjnore lidhur me saktësinë e besimit të atyre që i duan xhamitë, që i mbushin ato. Pra, shohim se xhamitë ndryshojnë gjatë Ramazanit, se njerëzit gjallërohen e aktivizohen

gjatë tij duke mbushur xhamitë, dhe kjo si rezultat i besimit dhe mirësisë që kanë në zemra.

Po ashtu, ato mbushen me ata njerëz mëkatarë që kërkojnë të pendohen e të kthehen tek Allahu. Atyre ua lexojmë ajetin: **“O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti”**. Zumer 53. Shohim prani të madhe të tyre në xhami, sikur ajo i thërret ata dhe u thotë: **“Ejani te Zoti i Mëshirshëm, te falja e mëkateve, te shpërblimi i madh i Tij!”**

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kush shkon në xhami në mëngjes apo në mbrëmje, Allahu ia përgatit një gosti dhe një vend në Xhenet sa herë që shkon.”**

## **RAMAZANI NDRYSHON NJERËZIT E MIRË, VEPËRMIRËT**

Ndryshimi i njerëzve të mirë ndodh kur ata ndryshojnë nga të qenët të mirë duke u bërë edhe më

të mirë dhe nga bujarë duke u bërë edhe më bujarë. Sezoni i Ramazanit është i tillë që ndryshon edhe njerëzit e mirë. Këtë e vërejmë edhe te vetë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, i cili ishte njeriu më bujar, ndërsa kur hynte Ramazani i shtohet bujaria, dorëdhënia, mirësitë, veprat e mira, adhurimi, leximi i Kuranit, ndihma ndaj të tjerëve dhe mësimi i tyre.

Gjatë Ramazanit ndryshojnë edhe mëkatarët. Edhe ata pa dyshim se janë muslimanë, të cilët kanë ngatërruar disa vepra të mira e disa vepra të këqija.

Vërejmë se gjatë Ramazanit ata e respektojnë atë, me përjashtim të atyre të cilëve u është vulosur zemra dhe tek ta nuk ka dallim Ramazani prej ditëve të tjera të vitit. Ne kemi për qëllim ata mëkatarë të cilët në zemra kanë dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe ndaj besimtarëve, por që shpirti e egoja i mund ata dhe i tërheq drejt gjynaheve dhe shkatërrimit. Mirëpo, prapëseprapë përpiqen aq sa kanë mundësi që të pendohen tek Allahu. Kjo është një shenjë e mirë tek ta (përpjekja për të qenë në rrugën e drejtë). Allahu thotë: **“Ata që luftojnë e**

**përpiqen për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët".** Ankebut 69.

Mëkatarët gjatë Ramazanit marrin hapin e parë drejt ndryshimit dhe reformimit. Hapi i parë është shkuarja në xhami për namaz me besimtarët e tjerë, vizitimi i saj pas një kohe të gjatë bojkoti/largimi, po ashtu kur fillojnë të agjërojnë, të lexojnë Kuranin, disa prej tyre përulen e nënshtrohen para Allahut dhe janë të vendosur në braktisjen e mëkateve dhe në pendim. Vërejmë se ata edhe japin për hir të Allahut. Allahu thotë: **"Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë."** Ta he 82.

Këtu patjetër duhet të tërheqim vërejtjen ndaj imemit të xhamisë. Nëse vërehet prezenca e këtyre njerëzve në xhami, atëherë ai duhet ta shfrytëzojë këtë në aspektin më të mirë të mundshëm, duhet t'iu dëshirojë mirëseardhje, të sillet butë me ta, të flasë fjalë të mira ndaj tyre, t'i mbushë në aspektin e besimit, me gjëra që bëjnë ta duan namazin e agjërimin dhe që i forcojnë në rrugën e drejtë. Nuk

është mirë të përsëritet në prani të tyre fjala: *“Sa njerëz të këqij janë ata që e njohin Allahun veçse në Ramazan”*, sepse koha në të cilën po jetojmë ka ndryshuar shumë, kanë ndryshuar edhe njerëzit, e ambiciet e tyre janë dobësuar dhe janë zbehur.

### **RAMAZANI NDRYSHON GJYMTYRËT E NJERIUT**

Allahu thotë: **“Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi.”** Isra 36.

Njeriu gjatë agjërimit ruan shikimin e tij, e përdor vetëm në gjëra të lejuara e të dobishme.

Po ashtu, ruan dëgjimin e tij, prezanton vetëm në ndeja ku përmenden bisedat e mira, ku mësohet për fe apo për gjëra të tjera të dobishme, largohet nga ndejat e kota të cilat bëjnë të mëkatojë e të jetë pjesëmarrës me të tjerët në mëkat.

Ai ruan edhe gjuhën e tij, gdhend moralin e tij, flet vetëm fjalë të mira dhe e zgjat heshtjen. Ai shenjë dalluese e tij është: **“Unë jam agjërueshëm!”**

Dora i lëviz vetëm në gjëra të mira, nuk prek me të apo të konsumojë gjëra të cilat ia prishin agjërimin, me të ndihmon nevojtarët e nuk u shkakton shqetësime e lëndime të tjerëve.

Këmba e tij ecën vetëm drejt të mirave, si: për në xhami, apo për të vizituar një të sëmurë, apo për të bërë vizita të lejuara, apo për të ndihmuar dikë, apo për të pajtuar mes njerëzve, apo për t'i udhëzuar të tjerët, largimi nga vendet e këqija e të kota, sepse e di se çdo hap që hedh e lëvizje që bën, kjo i shkruhet dhe do të japë llogari për të tek Allahu.

Pra, të gjitha gjymtyrët e ndjejnë Ramazanin, mirëpo para se gjithash, kryesorja në këtë duhet të jetë zemra, në mënyrë që njeriu të agjërojë me agjërim të pastër, të vërtetë e të sinqertë për Allahun.

Zemra duhet të jetë e atillë që ndikohet nga këshillat e Kuranit. Njeriu duhet ta pastrojë zemrën e tij nga sëmundjet dhe defektet e saj, duhet ta mbushë atë me sinqeritet ndaj Allahut, ta ndriçojë me këshillat e porositë e vyera që i dëgjon në xhami apo i lexon në libra. Pastaj, të gjitha këto i reflektojnë në gjymtyrët e

tij, në pjesët e trupit të tij, andaj do të flasë vetëm fjalë të mira dhe do të ecë vetëm drejtë punëve të mira.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Vini re! Në trup është një copë mishi, nëse ajo është e mirë, atëherë i tërë trupi do të jetë i mirë e nëse ajo është e prishur, atëherë i tërë trupi do të priset. Vini re! Ajo është zemra.”**

## **RAMAZANI NDRYSHON GJENDJEN EMOCIONALE**

Ramazani ndryshon pikëllimet e njeriut. Ai është burim lumturie, qetësie e gëzimi shpirtëror.

Edhe pse Ramazani përmban në vetvete etje, uri, lodhje e rraskapitje, megjithatë, kur njeriu agjëron ndjen një shpresë të madhe në shpirt, siguri, rehati, gëzim e lumturi. Këto gjëra i hijeshon e i ushqen agjërimi që njeriu e bën për hir të Allahut, përmendja e Tij, leximi i Kuranit, nxitimi drejt veprave të mira, shpirti i qetë, sepse e ndjen se është duke kryer një obligim madhështor për hir të Allahut, ndjen dashuri të madhe për Atë dhe ndjen rehati e komoditet shpirtëror.

Pastaj kur të afrohet iftari kaplohet nga një gëzim tjetër, për të cilin Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Agjëruesi ka dy gëzime: njëri kur çel iftarin dhe tjetri kur takon Zotin e tij”**. Gëzohet ngase Allahu e ka ndihmuar të plotësojë ditën e agjërimit, ndjen rehati e qetësi shpirtërore, i gëzohet mirësive të Allahut dhe ushqimeve që ka përpara.

Nëse ndalemi dhe i mendojmë të gjitha këto, kjo bën që të na ripërtërihet shpresa dhe të jemi sa më larg pikëllimeve (të së kaluarës) dhe brengave (për të ardhmen). Muslimani këto i largon përmes ëmbëlsisë së agjërimit, ripërtëritjes shpirtërore të cilën e përfiton nga dhikri e bindja ndaj Allahut dhe përmes kënaqësisë të cilën e shijon kur bashkohet me muslimanët për teravi.

Sikur gjendja e tij thotë se Ramazani është muaji i rehatisë shpirtërore, gëzimit të madh dhe lumturisë, jo vetëm i rraskapitjes, urisë dhe etjes. Sikur thotë: *“Unë gëzohem e jam i lumtur për çdo ditë e çdo çast të Ramazanit. Nuk ka pikëllim e brenga në këto ditë e netë të ndritura të Ramazanit!”* Andaj, e falënderojmë Allahun e Lartësuar për begatitë e tij të mëdha, për

begatinë e agjërimit, faljes së namazit së natës dhe iftarit.

## **RAMAZANI NDRYSHON VESET E KËQIJA**

Ramazani ndryshon edhe shprehitë e njerëzve. Ka shprehi të cilat nuk janë dhe aq të mira, por janë të këqija, me të cilat sprovohen disa njerëz. Megjithatë, Ramazani me lejen e Allahut i ndryshon ato në mënyrë që njeriu të bëhet më i mirë e më i ngritur.

Shembull: Disa njerëz para Ramazanit janë përtacë në kryerjen e veprave të mira dhe një kohë të madhe të ditës e kalojnë në gjumë, megjithatë posa të hyjë Ramazani ka mundësi të largojnë këtë shprehi të keqe, dhe kjo ndodh kur ata ngrenë ambicien dhe vendosmërinë, duke u bërë pjesëmarrës me agjëruesit e tjerë të cilët i shohin përreth se si garojnë drejt bindjes tek Allahu dhe punëve të mira.

Disa të tjerë pinë duhan, por në Ramazan detyrohen ta braktisin atë në mënyrë që agjërimi i tyre të jetë i saktë dhe i vlefshëm. Mirëpo, besimi i tyre tek Allahu dhe ndjesia se Ramazani është muaj i vlefshëm e me

pozitë të lartë, kjo bëhet derë e rëndësishme e madhështore për braktisjen e tërësishme të duhanit.

Njeriu duhet të sjellë ndërmend se është në muajin e Kuranit, në muajin e bamirësisë e dorëdhënies, në muajin e nxitimit drejt punëve të mira, në muajin i cili është shans i artë dhe dhuratë e madhe prej Allahut. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Qoftë i poshtëruar ai njeri i cili arrin Ramazanin dhe përfundon ai e nuk bëhet shkak që t’i falen mëkatet!”**

Të kuptuarit e rëndësisë së madhe që ka Ramazani - kjo mjafton të zgjosh vetveten nga gjumi e shkujdesja, pa marrë parasysh sa e madhe është ajo.

Sill ndërmend se je në një muaj në të cilën është një natë e cila është më e mirë sesa njëmijë muaj, e ajo është nata e Kadrit. Allahu thotë: **“Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj”**. Kadr 3.

Kur të hyjnë dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, ndalu e mendo rreth gjendjes tënde, se si do t’i ngjallësh e t’i mbushësh ato me adhurime. Mundohu t’i ngjasosh Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem sa më

shumë në gjendjen e tij, sepse kur hynin këto dhjetë netë, ai përpiquej shumë në adhurim, zgjonte edhe familjen e tij dhe e ngjallte natën me adhurim. Këto janë shenja se njeriu është serioz dhe është përgatitur ashtu siç duhet për të shfrytëzuar sa më mirë Ramazanin.

Andaj, pse të mos i shfrytëzojmë këto ditë e netë?! Shëndetin e kemi, begatitë e Allahut na rrethojnë nga çdo anë, shkaqet janë të pranishme. Allahu tregon se i do robërit e Tij të devotshëm. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem thotë në një hadith kudsij se Allahu ka thënë: **“Vazhdon robi Im të afrohet tek Unë me vepra vullnetare derisa ta dua...”**

Shprehinë e dembelisë dhe gjumit, Ramazani e kthen në shprehi të seriozitetit, përpjekjes së madhe, gjallërisë e aktivitetit. Ngrënien e tepërt apo shprehitë e këqija në lidhje me të ushqyerit, Ramazani i shndërron në shprehi të mira e të shëndetshme.

Nëse njeriu është i ngathtë në punë të mira, Ramazani e shtyn përpara që sa më shumë t'i shtojë ato.

Ndejat e dëmshme për njeriun, Ramazani e bën që t'i zëvendësojë me ndeja që janë të dobishme për të. Pra, çdo gjë mund të ndryshojë së bashku me Ramazanin. Vetëm se, kthehu tek Allahu, kërko ndihmën e Tij dhe mos u ligështo.

### **RAMAZANI NDRYSHON LIDHJET FAREFISNORE**

Ndodh që para Ramazanit pjesëtarët e farefisit të shkëpusin lidhjet mes veti, pastaj (kjo bën që) problemet të rriten aq shumë sa që më nuk i flasin njëri-tjetrit dhe bojkotohen. Mirëpo, vjen Ramazani dhe menjëherë bëhet shkak që këto lidhje të afrohen e të forcohen mes farefisit dhe që urrejtja e sëmundjet e ndryshme të largohen nga zemrat, sepse (gjatë Ramazanit) shpirtrat janë të përulur para Allahut, zemrat janë pastruar dhe janë nënshtruar tek Ai dhe veprat që bëhen janë të shumta.

Allahu duke treguar për rrezikun e shkëputjes së lidhjeve farefisnore, thotë: **“...dhe do t’i shkatërronit lidhjet farefisnore. Këta janë ata, të cilët Allahu i ka mallkuar”**. Muhamed 22-23. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem thotë: **“Nuk do të hyjë në Xhenet ai që i shkëput lidhjet me farefisnin.”** Andaj, patjetër duhet të marrim iniciativën që gjatë Ramazanit t’i shpeshtojmë vizitat me të afërmit tanë.

Nëse kemi mosmarrëveshje e armiqësi me ta, atëherë këto vizita do të bëhen shkak sado pak për zbutjen e këtyre plagëve dhe që pala tjetër të jetë e gatshme për pajtim dhe për rregullim të raportit.

Ajo që ka rëndësi është që ideja e faljes dhe e mbajtjes së lidhjeve farefisnore, të përhapet sa më shumë në mesin e njerëzve gjatë Ramazanit dhe ata të ndjejnë se ai është muaj i mbajtjes së lidhjeve, i faljes së ndërsjellë dhe i pajtimit. Ai nuk është muaj i grindjeve dhe mosmarrëveshjeve.

Nuk ka vend për urrejtje e gjëra të këqija në një zemër e cila është e mbushur me dashuri ndaj Ramazanit, e cila e shijon ëmbëlsinë e Kuranit, e cila e lexon atë dhe

përulet kur dëgjon Fjalët e Allahut. Përndryshe, çfarë vlere do të kishte përmirësimi yt gjatë Ramazanit nëse nuk mban lidhjet me farefisën dhe të afërmit dhe nuk braktis sjelljet injorante?!

Gjatë Ramazanit besimtari lexon Kuran, prezanton në namazin e teravive, dëgjon Fjalët e Allahut, të mbushura me porosi dhe këshilla madhështore. Andaj, si ka mundësi që një zemër e pastër të dëgjojë Fjalët e Allahut e pastaj të mos zgjohet nga shkujdesja e gjumi dhe të mos ketë përfitim nga to?!

### **RAMAZANI NDRYSHON GËZIMET TONA**

Para Ramazanit, ndodh që njeriu t'i gëzohet marrjes së ndonjë diplome, apo ndonjë suksesi, apo ndonjë përfitimi material, apo ndonjë takimi me njerëzit që do, mirëpo në Ramazan gëzohemi në aspektin e besimit.

-Fillimisht, gëzohemi sepse Allahu na mundësoi të arrijmë Ramazanin, i gëzohemi shumë këtij fakti dhe urojmë njëri-tjetrit, mirëpo edhe përgatitemi që ta shfrytëzojmë atë ashtu siç është më së miri.

-I gëzohemi agjërimit të Ramazanit, këtij adhurimi madhështor, siç thotë për të Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem: **“Nuk ka të ngjashëm me të.”**

-I gëzohemi leximit të shumtë të Kuranit.

-I gëzohemi mposhtjes së mllëfit, ruajtjes së gjymtyrëve, ruajtjes së gjuhës sonë, gëzohemi kur ngrehim lartë shenjën **“Unë jam agjërueshëm!”** dhe kur nuk i bëjmë të ngjashme ditët e agjërimit me ditët e tjera të vitit.

-I gëzohemi nxitimit drejt veprave të mira.

-I gëzohemi çastit të çeljes së iftarit dhe gëzohemi kur hamë ushqimin që na ka lejuar Allahu pasi e kishim të ndaluar (gjatë agjërimit). Kështu, e falënderojmë Allahun për begatitë e Tij të shumta dhe na shtohet dashuria për agjërimitin, sepse ai është nga shkaqet e futjes në Xhenet. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Agjëruesi ka dy gëzime: njëri kur çel iftarin dhe tjetri kur ta takojë Zotin e tij.”**

-I gëzohemi tubimit të njerëzve për namazin e teravive, se si dëgjojnë me vëmendje leximin e Kuranit dhe të duket sikur je duke e dëgjuar për

herën e parë atë, i cili ta rrëmben zemrën dhe të vendosë në një Xhenet të përshpejtuar në jetën e kësaj bote.

-I gëzohemi ushqimit të varfërve e të ngratëve, mëshirimit të të dobëtëve, dhënies (shpenzimit) për jetimët, unifikimit të muslimanëve dhe vëllazërisë për hir të Islamit. Allahu thotë: **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër...”** Huxhurat 10.

-I gëzohemi ardhjes së ditës së Bajramit, e cila me gëzimin e lumturinë që ka, sado pak na lehtëson pikëllimin e trishtimin për largimin e muajit të Ramazanit. Pastrojmë trupat tanë, veshim rroba të mira e të bukura, shkojmë në xhami, urojmë njëri-tjetrit pas faljes së namazit të Bajramit dhe të gjithë tregohemi modest me njëri-tjetrit. Këtë shoqëri e mbizotëron lumturia dhe gëzimi. Të gjithë i harrojnë kundërshtitë e mosmarrëveshjet që kanë ndërmjet vete, afrohen dhe realizojnë lidhjen vëllazërore. Bashkohen mes vete, **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër”** Saf 4. Të gjithë gëzohen. Bëhen bashkë i pasuri dhe i varfëri. I gëzohen Bajramit, festës madhështore të Islamit, e duan njëri-tjetrit, afrohen

dhe tregohen të butë mes vete. Kështu largohet mendjemadhësia, kryelartësia e bojkoti mes muslimanëve. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Shembulli i besimtarëve në dashuri, mëshirë e ndjenja të ndërsjella, është sikur shembulli i një trupi të vetëm, nëse një pjesë ankon i tërë trupi pastaj rënkon nga pagjumësia, temperatura dhe ethet.”** Andaj, le t’i gëzohemi festës së Bajramit, të largojmë nga vetja pikëllimet e brengat dhe të ndjejmë begatinë e madhe të Allahut të cilën na ka dhënë.

Pastaj besimin e përfituar gjatë Ramazanit dhe punët e mira, le t’i shfrytëzojmë për pjesën e mbetur të vitit.

Lusim Allahun të na japë sukses të gjithëve  
drejt çdo të mire!